



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit

Nr. 960/7 Prot.

Tiranë, më 26/12/2016

V E N D I M

Nr. 162, Datë 26/12/2016

PËR

EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË KRYER NË DEGËN RAJONALE TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË MJEDISIT DHE PYJEVE VLORË “PËR ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË RREGULLSHMËRISË TË AKTIVITETIT TË INSTITUCIONIT NË PROCEDURËN E INSPEKTIMEVE, DHE VEPRIMTARINË EKONOMIKO-FINANCIARE ”.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës, mendimin e Drejtorit Përgjithshëm, vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të mësipërm, në mbështetje të neneve 10, 15 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit “*Auditim tematik dhe vlerësues për ligjshmërinë rregullshmërinë e aktivitetit të institucionit, mbi procedurën e dokumentimit ne kryerjen e inspektimeve dhe veprimtarinë ekonomiko-financiare*”, ushtruar në Degën Rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve Vlorë”, për periudhën 01.01.2014 deri më 30.06.2016.

II. Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

A. MASA PËR PËRMIRËSIM LIGJOR

Gjetje 1: DRISHMP Vlore, në kryerjen e inspektimeve nga Sektori Pyjor për periudhën *viti 2014, 2015 dhe 6/mujorin e I-rë 2016*, krahas vendosjes së *11 gjobave në vlerën 600 mijë lekë, ka*

vendosur në 13 procesverbale edhe masa sekuestruese të 63,52 mst dru zjarri dhe 70 bandjera pishe (emërtim i përdorur jo sipas emërtesës së asortimenteve të lendes drusore pyjore); nga të cilat: në vitin 2014 janë 4 procesverbale sekuestrimi të 17,32 mst dru zjarri krahas vendosjes së 4 gjobave në vlerën 220 mijë lekë dhe në vitin 2015 në 9 procesverbale sekuestrim të 46,2 mst dru zjarri (veçuar për Bashkia Finiq 16 mst) dhe 70 copë bandjera pishe, krahas vendosjes së 7 gjobave në vlerën 380 mijë lekë paraqitur në tabelën emërtuar “Tabela e Sekuestrimeve të Materialit Drusor te Kapur dhe Administrimi Përfundimtar për v. 2014,2015” bashkëlidhur;

Nisur nga tabela, mënyra e dokumentimit, dorëzimit dhe marrjes në dorëzim të Materialit drusor të sekuestruar në vitin 2014, 2015 sipas 13 procesverbaleve në sasinë prej 67,5 mst dorëzuar përkatësisht në personat e pa autorizuar të DSHP Vlore 51,5 mst (47,2 mst Sarandë dhe 4,3 mst Vlore) dhe 16 mst dorëzuar në Bashkinë Finiq, pra pa dokumentuar marrja në dorëzim me flete hyrje dhe pa verifikuar e matur në vend; mënyrë administrimi kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kreu III “Dokumentimi i lëvizjes së Aktiveve” pika 34, 37 e vijim **ku shprehet:** “...Hyrja e aktiveve në magazine dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre...”,

Ndërsa prej shtatori v. 2014 dhe gjatë v.2015, administrimi prej 67,5 mst materiali drusor i sekuestruar dhe dorëzuar përkatësisht në DSHP Vlore 51,5 mst (47,2 mst Sarandë dhe 4,3 mst Vlore dhe 16 mst Bashkia Finiq) është bërë sipas njoftimit të DSHP Vlorë me shkresën nr. 5/59, datë 23.07.2015, ku bashkëlidh kontratën datë 23.07.15 me subjektin “E”, me objekt shfrytëzim lëndë drusore në këmbë në EP “Kume–Shushicë” dhe pjesë e kësaj kontrate në faqe 4, është dhe shitja e **20,69 m³ material drusor** (sipas llojit 2,5 m³ pishë dhe 18,19 m³ fletor, me asortimente 5,84 m³ lenë punimi (2,5 m³ pishë dhe 3,34 m³ fletor) si dhe 14,85 m³ dru zjarri fletorë. Pra DSHP ka shitur si pjesë të kontratës sasinë prej 20,69 m³ material drusor kundrejt 31,02 m³ të marra në dorëzim, pra **më pak -10,51 m³** (31,2-20,69) llogaritur dhe konvertuar në raportin (1m³=1,66 mst) që rezulton 51.5 mst:1,66 mst/m³=31,2 m³.

Diferenca prej-10,51m³ ose 17,4 mst ndërmjet sasisë materialit të sekuestruar sipas 13 procesverbaleve të ISHMP (**51.5 mst:1,66 =31,02 m³**) dhe sasisë materialit drusor të shitur nga DSHP (20,69 m³x1,66 mst=**34,3 mst**) vjen **së pari:** nga vonesa prej gati 10 muajsh (23.7.2015-20.09.2014), në ekzekutimin e ankandit manipulimit dhe grumbullimit të materialit drusor nga DSHP Vlorë,

Së dyti: Në Udhëzim të Ministrit Mjedisit me nr. 1, datë 04.07.2014 “Mbi Standardizimin e Shkëmbimit të Informacionit Zyrtar dhe Bashkëpunimin e Ndërsjellët Ndërmjet Strukturave të Vartësisë së Ministrisë Mjedisit”, pika 4.b ku shprehet: “...(DSHP).. merr masa për magazinimin dhe më pas shitjen me ankand të mallit/materialit drusor.... të bllokuar/sekuestruar në brendësi të fondit pyjor kombëtar ose jashtë tij...” dhe pika 5.f ku shprehet: “...Sektorët e Inspektoratit të Policisë Pyjore të Degëve Rajonale të ISHMPU detyrohen ti përcjellin DSHP-ve: ... f. Procesverbalet e sekuestrimit të lëndës drusore të bllokuar e sekuestruar në pyll dhe në rrugë auto...”; në të dy këto pika të udhëzimit nuk përcaktohet qartë mënyra ligjore e administrimit, kontrollit dhe destinacionit final të materialit drusor të sekuestruar, pra nuk përcakton mënyrën e dokumentimit me dokumentin fletë hyrje, fletëdalje në procesin e marrjes dhe dorëzimit nga ISHMP tek administruesit dhe menaxhuesit e Pyje-kullotave (ish DSHP, DGZM dhe së fundi Organet e NJQV që do kryejnë këtë funksion); gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kreu III “Dokumentimi i lëvizjes së Aktiveve” pika 34, 37 e vijim **ku shprehet:** “...Hyrja e aktiveve në magazine dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre.”(Trajtuar më hollësisht në faqe 31-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 20: DRISHMP Vlore dhe ISHMP Tiranë të marrin masa të hartojnë kërkohen dhe miratojnë te Ministri i Mjedisit një Udhëzim të ri lidhur me “Mbi Standardizimin e Shkëmbimit të Informacionit Zyrtar dhe Bashkëpunimin e Ndërsjellët Ndërmjet Strukturave të Vartësisë së Ministrisë Mjedisit, NJQV-ve dhe ministritë e tjera” dhe të shfuqizojnë Udhëzimin nr. 1, datë 04.07.2014 “Mbi Standardizimin e Shkëmbimit të Informacionit Zyrtar dhe Bashkëpunimin e Ndërsjellët Ndërmjet Strukturave të Vartësisë së Ministrisë Mjedisit”, pasi:

a.- Në Udhëzim të Ministrit Mjedisit me nr. 1, datë 04.07.2014 “Mbi Standardizimin e Shkëmbimit të Informacionit Zyrtar dhe Bashkëpunimin e Ndërsjellët Ndërmjet Strukturave të Vartësisë së Ministrisë Mjedisit”, pika 4.b ku shprehet: “...*(DSHP).. merr masa për magazinimin dhe më pas shitjen me ankand të mallit/materialit drusor.... të bllokuar/sekuestruar në brendësi të fondit pyjor kombëtar ose jashtë tij...*” dhe pika 5.f ku shprehet: “...*Sektorët e Inspektoratit të Policisë Pyjore të Degëve Rajonale të ISHMPU detyrohen ti përcjellin DSHP-ve: ... f. Procesverbalet e sekuestrimit të lëndës drusore të bllokuar e sekuestruar në pyll dhe në rrugë auto...*”; në të dy këto pika të udhëzimit nuk përcaktohet qartë mënyra ligjore e administrimit, kontrollit dhe destinacionit final të materialit drusor të sekuestruar, pra nuk përcakton mënyrën e dokumentimit me dokumentin fletë hyrje, fletëdalje në procesin e marrjes dhe dorëzimit nga ISHMP tek administruesit dhe menaxhuesit e Pyje-kullotave (ish DSHP, DGZM dhe së fundi Organet e NJQV që do kryejnë këtë funksion); që nga mangësitë e mësipërme ka sjellë si pasojë keqadministrim gjatë marrjes në dorëzim dhe dorëzimit si dhe administrimin përfundimtar të materialit drusor të sekuestruar në sasinë prej **10,51 m³**, gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, kreu III “Dokumentimi i lëvizjes së Aktiveve” pika 34, 37 e vijim **ku shprehet:** “...*Hyrja e aktiveve në magazine dokumentohet në çdo rast me fletëhyrjen përkatëse, të hartuar sipas gjendjes fizike të tyre*”,

b.-Aktualisht Udhëzimi nr. 1, datë 04.07.2014, është i pa përditësuar, nuk është funksional pasi nuk pasqyron ndryshimet strukturore dhe vartësitë e tyre si DSHP-të, Ujërat, si dhe nuk përfshin detyrimet e bashkëpunimin me NJQV-të dhe Ministritë e tjera si Ministria e Bujqësisë Zhvillimit Rural dhe Ujërave etj.

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

Gjetje 1: DRISHMP Vlorë (ish-DRISHMPU) prej 2 vjetësh nga krijimi deri 30.6.2016, nuk ka të hartuar e miratuar dokumentin emërtuar “**Deklarata e Qëllimit, misionit, vizionit dhe objektivave Themelorë të aktivitetit**” dokument i cili do të pasqyronte në mënyrë të qartë e koncize Misionin, Vizionin dhe në mënyrë të matshme e krahasueshme treguesit kryesor të arritur për **objektivat themelor të aktivitetit në zbatim të kërkesave të ligjit** nr.10296, datë 08.07.2010 ”Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, (kreu i dytë dhe i tretë) (*Trajtuar më hollësisht në faqe 86-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 1: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, Njësia e Financës, Përgjegjësit e Sektorëve të hartojnë, miratojnë në **ISHMP Tiranë dokumentin** emërtuar “**Deklarata e Qëllimit, misionit, vizionit dhe objektivave Themelorë të aktivitetit**” bazuar në VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, Kreu V pika 5, **me mision Garantimin dhe respektimin e kërkesave ligjore në Fushën e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Pyjeve bazuar ne 5 parimet përcaktuar ne nenin 5, 6, 7,8 dhe 9, të ligjit** nr. 10433, datë 16.06.2011”Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, **të cilat i japin institucionit jo vetëm funksione ligj zbatuese por edhe funksione parandaluese, këshilluese, edukuese për reagim të kulturuar të Publikut ndaj mjedisit dhe Pyjeve.**

Gjetje 2: Në DRISHMP Vlorë, Njësi Publike që funksionon prej një kohe të kufizuar eksperience (2 vjet), prej datës 21.2.2014, mungon dhe nuk është përcaktuar hartuar dokumenti “Strategjia afatmesme e menaxhimit të risqeve parësore që pengojnë realizimin e objektivave kryesore njëkohësisht dhe ne hartimin e zbatimin e Plan Buxhetit Afatmesëm”, dokumenti i “Regjistrin të Riskut”, “Strategjia dhe Planveprimet e Menaxhimit të Riskut, Koordinatorin” në mospërmbushje të nenit 21 (i cili përcakton bazat për menaxhimin e riskut), të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të *Manualit “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” shtojcat përkatëse 6,7 dhe Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016”Për Përgjegjësitë dhe Detyrat e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatorit të Riskut në Njësitë Publike” (Trajtuar më hollësisht në faqe 86-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 2: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, Njësia e Financës, Përgjegjësit e Sektorëve të hartojnë miratojnë ndjekin e zbatojnë dokumentet “Strategjia afatmesme e menaxhimit të risqeve parësore që pengojnë realizimin e objektivave kryesore njëkohësisht dhe të hartimit zbatimit Plan Buxhetit Afatmesëm”, dokumenti “Regjistrin të Riskut”, “Strategjia dhe Planveprimet e Menaxhimit të Riskut, Koordinatorin”, nisur nga përdorimi i burimeve identifikuar gjatë procesit të auditimit, trajtuar hollësisht më sipër.

Gjetje 3 : Në DRISHMP Vlorë, lidhur me hapat që duhen ndjekur për instalimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (SMFK) mungojnë dhe nuk janë përcaktuar hartuar e zbatuar dokumentet si :

1. Nuk është hartuar miratuar nga GSM Plani i Veprimit Afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit dhe përgatitjen e gjurmëve të auditit për procedurat specifike të institucionit, çka është në mospërmbushje të Kreut të III, nenet 19-22 të nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2. Mungojnë e nuk janë caktuar nga Titullari, procedurat e brendshme të antikorrupsionit dhe sinjalizimit të parregullsisve, që është në mospërmbushje të nenit 8, pika 8 (e) dhe të nenit 17 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

3. Mungon përshkrimi i proceseve dhe veprimeve, miratimi i tyre lidhur ne qarkullimin e dokumentacionit shkresor dhe përfshirja e tyre e normuar me rregulloren përkatëse në zbatim të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 dhe të udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe dokumentacioni i AQT.

4. Nuk është miratuar gjurma e auditimit, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe, Urdhrit të Ministrit të MF nr. 29, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

5 Rregullorja e Brendshme e funksionimit, nr. 1, datë 15.09.2014, “Për Organizimin Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave në nivel qendror dhe rajonal“, miratuar me shkresën nr. 1166, datë 16.9.2016 të Kryeinspektorit është prej 2 vjetësh e pa përditësuar, ndërsa institucioni ka pësuar ndryshime strukturore nga VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, që përveç se duhet përshtatur, por duket të përfshije edhe proceset lidhur me instalimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në nivel Njësie DRISHMP, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 dhe të udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe dokumentacioni i AQT (*Trajtuar më hollësisht në faqe 86-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

Rekomandim 3: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, Njësia e Financës, Përgjegjësit e Sektorëve të hartojnë miratojnë ndjekin e zbatojnë dokumentet lidhur me hapat që duhen ndjekur për instalimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (SMFK) emërtuar si:

Plani i Veprimit Afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit dhe përgatitjen e gjurmëve të auditit për procedurat specifike të institucionit, procedurat e brendshme të

antikorrupsionit dhe sinjalizimit të parregullsive nga Titullari; përshkrimi i proceseve dhe veprimeve, miratimi i tyre lidhur me qarkullimin e dokumentacionit shkresor dhe përfshirja e tyre e normuar me rregulloren përkatëse; si dhe dokumenti gjurma e auditimit, në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe, Urdhrit të Ministrit të MF nr. 29, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi

Gjetje 4: Në DRISHMP Vlorë dhe ISHPM Tiranë, Rregullorja e Brendshme e funksionimit, nr. 1, datë 15.09.2014, “Për Organizimin Funksionimin e Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave në nivel qendror dhe rajonal“, miratuar me shkresën nr. 1166, datë 16.9.2016 të Kryeinspektorit është prej 2 vjetësh e pa përditësuar, ndërsa institucioni ka pësuar ndryshime strukturore nga VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, që përveç se duhet përshtatur, por duket të përfshije edhe proceset lidhur me instalimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në nivel Njësie DRISHMP, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 dhe të udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe dokumentacioni i AQT (*Trajtuar më hollësisht në faqe 86-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 4: DRISHMP Vlorë dhe ISHPM Tiranë të hartojnë e miratojnë Rregulloren e re të Brendshme të funksionimit, të përshtatur e përditësuar **dhe të mbështetur** në VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e Funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, rregullore e cila të përfshije edhe proceset lidhur me instalimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në nivel Njësie DRISHMP Qarku dhe në nivel Qendror ISHPM Tiranë.

Deri 30 Mars 2017

Gjetje 5: DRISHMP Vlorë, për periudhën deri në vitin 2016 ka hartuar Draft-Strategjinë 2014-2016, sipas urdhrit nr. 137/1, datë 25.08.2014, e cila është e pa miratuar nga Institucioni Qendror dhe për të cilën nuk u paraqit dokumentacioni i procedurave si dhe në strukturën e ndërtimit kjo *Draft –Strategji* ka mangësi, në përbërjen e saj mungonin e nuk përfshiheshin; 1. Një analizë e konsoliduar e gjendjes, e cila të përfshinte pikat e forta dhe mundësitë, pikat e dobëta dhe kërcënimet; 2. *Një matricë treguesish për* Qëllimet, objektivat, programet dhe projekt planet, 3. Matrica e prioritarizimit të projekteve (vendosje sipas radhës) 4. Fishat (treguesit) e Projekteve. Objektivat e renditura sipas faqeve 11-12, janë përshkrim me përmbajtje të përgjithshme, nuk shprehin karakterizojnë përcaktojnë asnjë tregues të matshëm, krahasueshëm etj, për të mundësuar matjen e realizimit në periudhat përkatëse me synim që ky dokument të bëhej funksional në shërbim të ngritjes së treguesve të tjerë dhe në argumentim të hartimit zbatimit, së PB dhe PBA në përmbushje të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe të udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik”, ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, dhe VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, dhe për monitorimin e treguesve të tij nuk u paraqit një dokument, raport analizë, nivel treguesish të matshëm të arritur të plotë apo të pjesshëm për periudhën 2014-30.6.2016, duke mos përmendur tregues menaxhues të pasqyrimin të veprimtarisë operative të DRISHMP Vlorë (*Trajtuar më hollësisht në faqe 86-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 5: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, Njësia e Financës, Përgjegjësit e Sektorëve të hartojnë, miratojnë dhe 5 ndjekin e zbatojnë dokumentin e Strategjisë dhe Planin strategjik, në zbatim të procedurave përkatëse mbështetur në 1. Një analizë e konsoliduar e cila të përfshinte pikat e forta dhe mundësitë, pikat e dobëta dhe kërcënimet; 2. *Një matricë treguesish për* Qëllimet,

objektivat, programet dhe projekt planet, 3. Matrica e prioritarizimit të projekteve (vendosje sipas radhës) 4. Fishat (treguesit) e Projekteve, duke përcaktuar qartë tregues të matshëm, krahasueshëm etj, për të mundësuar matjen e realizimit në periudhat përkatëse me synim që ky dokument të bëhej funksional në shërbim të ngritjes së treguesve të tjerë dhe në argumentim të hartimit zbatimit, së PB dhe PBA në përmbushje si dhe duke u mbështetur në burimet si: a. Objektivat e Programit përkatës të Qeverisë në fushën e mbrojtjes Mjedisit dhe Pyjeve b. Legjislacioni përkatës në fushën Mjedisit dhe të Pyjeve, së bashku me strategjitë zhvillimore në fushat përkatëse, hartuar nga institucionet menaxhuese, përkatësisht ministritë, të identifikuar gjatë procesit të auditimit.

Deri 30 Mars 2017

Gjetje 6: Në DRISHMP Vlorë, nuk janë përgatitur e nuk janë raportuar tre dokumentet: 1. Deklarata e SKB, (Deklarata për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësisë), 2. Raporti për funksionimin e SKB (*Raporti për Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të DRISHMP Vlorë*) dhe 3. Pyetëtori i vetëvlerësimit të funksionimit të SMFK (*Pyetëtori i vetëvlerësimit të funksionimit të Komponentëve të Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit*) për vitin 2014 raportimi në 3/mujori I –rë viti 2015, për vitin 2015, raportimi në 3/mujori I –rë viti 2016; gjendje kjo në kundërshtim me pikat 4, dhe 23, nënen 4, me nenet 18, 28 të Ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 86-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 6: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, Njësia e Financës, Përgjegjësit e Sektorëve të hartojnë, miratojnë dhe monitorojnë dhe raportojë dokumentet:

1. Deklarata e SKB, (Deklarata për cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm të Njësisë),

2. Raporti për Funksionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për DRISHMP Vlorë, i me strukturën emërtuar “Raport për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm të Njësisë për vitin xxx” dhe me 5 komponentët përkatës përshkruar hollësisht më sipër,

3. Pyetëtori i vetëvlerësimit të funksionimit të SMFK “Për Funksionimin e Sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit për vitin xxx”, me 5 Komponentët Kryesor të Standardeve Ndërkombëtar të Kontrollit të Brendshëm (SNKB) si: (Mjedisi i Kontrollit, Menaxhimi i Riskut, Aktivitetet e Kontrollit, Informimi dhe Komunikimi, Monitorimi dhe Verifikimi), vlerësimet në pikëzim janë të pambështetura me komentet dhe që kundërshtohen nga mungesa e dokumenteve kryesore përkatëse si; objektivat, misioni vizioni, strategjitë, plan-veprime, rregulloret si dhe ku të përcaktohen Objektivat, Misioni dhe Vizioni i Njësisë, Deklarata e misionit vizionit dhe njohja e tyre nga punonjësit, dhe cilësimin i datën së miratimit të deklaratës sipas pyetjes nr. 1 të pyetëtorit, përmenden aktet kryesore si; plani strategjik i zhvillimit afat mesëm e afatgjatë; plani i veprimit afat shkurtër dhe objektivat.

Deri 30 Mars 2017

Gjetje 7: DRISHMP Vlorë ka hartuar dhe përgatitur **projekt buxhete PB dhe PBA-të** të viteve 2014, 2015, 2016 me moszbatim e shkelje procedurash ligjore, me mungesa dokumentesh argumentuese dhe Parashikime me rezerva, pra buxhete të pa argumentuar jo real funksional me mungesë bazushmërie treguesish dhe në mos përmbushje të funksioneve, qëllimit, objektivave të institucionit, si vijon:

a. Ka munguar hartimi i PB dhe PBA për **vitin 2014** pasi institucioni DRISHMP Vlorë ka filluar veprimtarinë me datë 21.2.2014, (PB/PBA bëhet në v. 2013), ka hartuar buxhetin **për vitin 2015**, dërguar me shkresën nr. 137, datë 25.08.2014, ndërsa **për vitin 2016** nuk është hartuar buxheti PB dhe PBA, pasqyruar në tabelën emërtuar “**Parashikimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën v. 2014, 2015 dhe 6/mujori I-rë v.2016**“, gjendje kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; me UMF nr. 8, datë 29.3..2012”Për Procedurat Standarde të Përgatitjes së PBA”, ligjit nr. 147/2015 “Për Buxhetin e

Vitit 2016”, dhe të Kapitulli IV pika 256 UMF nr. 2, datë 06.02.2012“Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit“,Udhëzimit nr. 4, datë 29.02.2016 “Për Përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017-2019 dhe sipas detajimeve të Tavaneve Buxhetore sipas tabelave Standard”.

b. Në përgatitjen e buxhetit të v.2015 (pasi viti 2016 nuk është hartuar) urdhri i brendshëm nr. 137/1, datë 25 .8.2014, përveç se është jo në kohën e duhur, nuk përmban citimin e akteve ligjore dhe nuk ka përmbajtjen formale dhe standarde, pasi grupit të ngritur duhej ti përcaktoheshin detyrat konkrete me afat (pra para datës 25.8.2014, që përkon me të njëjtën ditë të nisjes së projekt buxhetit),

c. Nuk janë respektuar kriteri rritjes prej 10%,nga viti në vit pasi nuk dëshmohen dokumentohen me tregues te tillë si numri i inspektimeve etj për produktet përkatës në fushën e Mjedisit, Pyjeve ,me kostot përkatëse të çdo inspektimi,etj tregues të matshëm dhe nuk mbështetet në Planveprime,vjetore e afatmesme, dokument i cili mungon për secilin vit 2015, 2016,

d. Buxheti (PB dhe PBA) i vitit 2015 nuk mbështetet në dokumentet e hartuara me vehte si Objektivat, Strategjia dhe planveprimet përkatëse të çdo viti, këto mbështetur dhe në zbatimin i Objektivave të Programit të Qeverisë dhe në strategjitë sektoriale në fushën e Mjedisit dhe Pyje Kullotave; që shërbejnë si shtylla orientuese, argumentuese; mangësi këto në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe nuk respektojnë kriterin e rritjes, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”,dhe udhëzimet përkatëse.

e. Ka munguar programimi dhe raportimi vjetor 2014, 2016 dhe 6/mujori 2016 (si pjesë e planveprimit mbi të cilën do të mbështetej edhe hartimi i projekt buxheteve përkatës) i numrit të inspektimeve i cili do të mund të parashikohej programohej me njërën prej metodave si **metoda Globale** duke u mbështetur në vitet e mëparshme, korrigtuar me detyrat apo objektiva specifike të vendosura nga institucioni qendror, dhe tjetra **metoda analitike** parashikuese për çdo proces apo produkt “mision inspektimi”, pasqyruar në tabelën emërtuar “**Parashikimi dhe realizimi i numrit të inspektimeve për vitin 2014, 2015 dhe 6/Mujori I-rë 2016 (në numër)**”;gjendje në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë“, nenin 7 dhe neni 16 ”Misioni dhe Funkcionet e Inspektoratit Qendror” pika 2 germat “b” dhe “c” ku shprehet se:”...**Miraton rregulla të Përgjithshme bazë për metodologjinë e vlerësimit të Riskut, programimin e inspektimeve dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit si dhe raportimin e veprimtarisë së inspektorateve.**” (Trajtuar më hollësisht në faqe 6-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 7: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori me strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, në bashkëpunim me ISHMP Qendër Tiranë, të hartojnë Projekt buxhete PB dhe PBA, të zbatojnë procedurat ligjore në kohë, mbështetur në ngritjen e Grupeve për Strategji e Buxhet (GSB), në Objektivat,Strategjinë, Planveprimet dokumente të hartuara me parë, në parashikimin e numrit dhe të kostove të produktit “Misione Inspektimi” në fushën e Mjedisit, Pyjeve ,me kostot përkatëse të çdo inspektimi, etj pra në tregues të matshëm, të zbatojë kriterin e rritje 10%, me synim hartimin e buxheteve të argumentuara dhe funksional për realizimin e funksioneve, misionit, objektivave, qëllimit dhe planveprimeve përkatës, përcaktuar në tabelën emërtuar “**Parashikimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën v. 2014, 2015 dhe 6/mujori I-rë v. 2016**” dhe në tabelën emërtuar “**Parashikimi dhe realizimi i numrit të inspektimeve për vitin 2014, 2015 dhe 6/Mujori I-rë 2016 (në numër)**”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

Gjetje 8: DRISHMP Vlorë në hartimin dhe përgatitjen e **projekt buxheteve PB dhe PBA** të viteve 2014, 2015, 2016, nuk ka parashikuar, vendosur programuar në zërin numër inspektimesh kategoria e aktiviteteve kulturalo-edukuese etj me operatorët, e biznesit, shoqatat, organizatat, Njësitë e Qeverisjes Vendore, Pleqësitë e zonave të banuara, lidhur me detyrat, detyrimet pasojat nga

keqpërdorimi i pyjeve mbrojtëse, prodhuese kullota-livadhe, bimësi pyjore etj, në lidhje me njohjen e ligjeve, zbatimin e tyre dhe pasojat nga moszbatimi, me synim rritjen e rolit edukues- parandalues dhe njohjen me pasojat ndëshkuese ligjor, në zbatim të ligjit 9385 datë 4.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, me nenin 12, pika 1, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 40 “Parimi i Këshillimit dhe informimit”, ku shprehet se:”1. Inspektori siguron këshillimin e subjekteve të interesuara për parandalimin dhe shmangien e kërkesave ligjore, në mënyrë të thjeshtë, të kuptueshme dhe pa pagesë,...” (Trajtuar më hollësisht në faqe 6-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 8: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori me strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, në bashkëpunim me ISHMP Qendër Tiranë, të marrë masa në hartimin e përgatitjen e Projekt buxheteve PB dhe PBA të parashikojnë, vendosin, programojnë dhe përcaktojnë kostot përkatëse të produktit, në zërin numër inspektimesh kategoria e aktiviteteve kulturalo-edukuese etj me operatorët, e biznesit, shoqatat, organizatat, Njësitë e Qeverisjes Vendore, Pleqësitë e zonave të banuara, lidhur me detyrat, detyrimet pasojat nga keqpërdorimi i Mjedisit, pyjeve mbrojtëse, prodhuese kullota-livadhe, bimësi pyjore etj, në lidhje me njohjen e ligjeve, zbatimin e tyre dhe pasojat nga moszbatimi, me synim rritjen e rolit edukues-parandalues dhe njohjen me pasojat ndëshkuese ligjor, në zbatim të ligjit 9385, datë 4.5.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, të ndryshuar, me nenin 12, pika 1, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 40 “Parimi i Këshillimit dhe informimit”.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

Gjetje 9 : DRISHMP Vlorë, Njësia e Financës, në çeljen zbatimin ndjekjen menaxhimin e realizimit të treguesve ekonomik dhe financiar të Buxhetit për veprimtarinë e viteve 2014, 2015 dhe 6 mujorin e I-rë 2016 u konstatua pamjaftueshmëri, mungesë performance shprehur në:

Parashikime me rezerva, buxhete të pa argumentuar jo real funksional që kanë sjellë pasojë nivele të ulëta realizimi përkatësisht: në vitin 2014 realizuar 82,8%, ose në shifra absolute buxheti është realizuar 17,083 mijë lekë kundrejt planit 20,630 mijë lekë, me diferencë mosrealizimi prej -3,547 mijë lekë; në vitin 2015 realizuar 86%, ose në shifra absolute buxheti është realizuar 18,474 mijë lekë kundrejt planit 21,389 mijë lekë, me diferencë mosrealizimi prej -2,915 mijë lekë dhe në 6/Mujorin e I-rë 2016 realizuar 64,7%, ose në shifra absolute buxheti është realizuar **9,470** mijë lekë kundrejt planit **6,131** mijë lekë, me diferencë mosrealizimi prej **-3,339** mijë lekë; pasqyruar në tabelën emërtuar “**Parashikimi dhe realizimi i buxhetit për periudhën v. 2014, 2015 dhe 6/mujori I-rë v. 2016**”, bashkëlidhur; gjendje kjo në kundërshtim me në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, dhe nuk respektojnë kriterin e rritjes, në kundërshtim me Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, dhe udhëzimet përkatëse, si dhe me ligjin nr. 185/2013, datë 2.12.2013 “Për Buxhetin e Vitit 2014”, ligjit nr. 160/2014, datë 27.11.2014 “Për Buxhetin e Vitit 2015”, ligjit nr. 147/2015 “Për Buxhetin e Vitit 2016”, dhe të Kapitulli IV pika 256 UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” (Trajtuar më hollësisht në faqe 6-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 9 : DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori me strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, të marrë masa të vazhdueshme për menaxhimin dhe ndjekjen e treguesve ekonomik dhe financiar zbatimit të Buxhetit periodik e vjetor dhe në situata mosrealizimi apo pamjaftueshmërie të marrë masa në kohën e duhur për ndryshimet përkatëse në zbatim të procedurave sipas nenit 45 të ligjit të Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë”, me synim shmangien e mospërdorimit apo të pamjaftueshmërisë dhe të pasojës mos përmbushjen e objektivave të institucionit.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

Gjetje 10 : DRISHMP Vlorë, Njësia e Financës, për *periudhën datë 20.05.2016 deri ne datë 30.06.2016* nuk ka parashikuar në Artikullin 602, në zërin “Shpenzime për Udhëtim e Dieta brenda vendit”, dhe nuk ka llogaritur e shpërblyer 6 punonjës në minimalisht *shumën 7500 lekë*, ndarë: E. B 1000 lekë, V. B 1000 lekë, E. M 1000 lekë, I M 2500 lekë, A. Q 1000 lekë dhe N. Ç 1000 lekë, si dhe për *periudhën 01.07.2016 deri 31.10.2016* nuk janë llogaritur e shpërblyer 6 punonjës në minimalisht *shumën 12 000 lekë*, ndarë: V .B 1500 lekë, I. M 8 000 lekë, A. Q 1000 lekë, L. P 500 lekë, B. M 500 lekë, dhe I .P 500 lekë, për shërbimet e kryera, si dhe nuk janë llogaritur shpenzimet për distancat mbi 100 km dhe për shërbimet që zgjatin mbi 3 ditë, në kundërshtim me VKM nr. 329, datë 20.04.2016 kreu III pika 2, ku shprehet: “Për shërbimet në një largësi mbi 50 km, jashtë qendrës së punës, kur punonjësi kthehet brenda ditës, trajtimi financiar i tyre përfshin djetën ditore në masën 500 lekë..” dhe sipas VKM nr. 148, datë 26/02/1998 “Për tarifatat e transportit të udhëtareve” pasqyruar në tabelën emërtuar “*Shërbime të kryera dhe pa urdhër-shërbime të plotësuara sipas VKM nr. 329, datë 20.04.2016 hyre ne fuqi datë 20.05.2016 për periudhën deri ne datë 30.06.2016 dhe në vijim*” (Trajtuar më hollësisht në faqe 6-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 10: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori dhe Njësia e Financës të marrin masa përfshijë në Artikullin 602, në zërin “Shpenzime për Udhëtim e Dieta brenda vendit” dhe të llogaritin e shpërblejnë për periudhën fund maji deri 30.06.2016 për 6 punonjës në minimalisht *shumën 7500 lekë*, përkatësisht: E .B 1000 lekë, V. B 1000 lekë, E. M 1000 lekë, I .M 2500 lekë, A. Q 1000 lekë dhe N. Ç 1000 lekë, si dhe për *periudhën 01.07.2016 deri 31.10.2016* të llogaritin e shpërbejnë 6 punonjës në minimalisht *shumën 12 000 lekë*, përkatësisht: V. B 1500 lekë, I. M 8 000 lekë, A. Q 1000 lekë, L. P 500 lekë, B. M 500 lekë, dhe I. P 500 lekë, për shërbimet e kryera dhe të pa likuiduara pasqyruar në tabelën emërtuar “*Shërbime të kryera dhe pa urdhër-shërbime të plotësuara sipas VKM nr. 329, datë 20.04.2016 hyre ne fuqi datë 20.05.2016 për periudhën deri ne datë 30.06.2016 dhe ne vijim*”.

Menjëherë

Gjetje 11: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori me strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, për periudhën 2014-6/mujori i I-rë 2016, në Relacionet raportet dhe tabelat e treguesve të nivelit të realizimit të numrit të inspektimeve përgatitur nga Sektori i Mjedisit dhe sektori i Pyjeve dhe ish sektori i Ujërave, sektorët e tjerë sipas strukturës, konstatojmë se kryesisht treguesit janë raportuar vetëm në nivelin faktik dhe jo të tabeluar e krahasuar me treguesit e parashikuar në Planet vjetore (të cilat mungojnë) dhe në Projekt buxhetet përkatëse, formë kjo raportimi jo e përputhur me normat e programimit, me kërkesat e ligjeve nr. 10296, datë 8.7 2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor ne Republikën e Shqipërisë” dhe udhëzimet përkatëse, me ligjin nr. 185/2013, datë 2.12.2013 “Për Buxhetin e Vitit 2014”, ligjit nr, 160/2014, datë 27.11.2014 “Për Buxhetin e Vitit 2015”, ligjit nr. 147/2015 “Për Buxhetin e Vitit 2016”, me Kapitullin IV pika 256 të UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë“, nenin 7 dhe neni 16” Misioni dhe Funkcionet e Inspektoratit Qendror” pika 2 germat “b” dhe “c” dhe me VKM nr. 46, datë 29.01.2014 “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit Pyjeve dhe Ujërave”(Trajtuar më hollësisht në faqe 6-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 11: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori me strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, në të ardhmen të marrin masa, që në ndjekjen dhe raportimin e treguesve ekonomik pasqyrimin dhe raportimin në Relacionet, raportet dhe tabelat e treguesve të nivelit të realizimit të numrit të inspektimeve treguesit të raportohen jo vetëm në nivelin faktik por dhe me nivelin e parashikuar, te programuar të krahasueshëm duke i tabeluar e krahasuar me treguesit e parashikuar në Planet vjetore (të cilat mungojnë) dhe në Projekt buxhetet përkatëse, formë kjo raportimi në përputhje me normat e programimit, me kërkesat e ligjeve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

Gjetje 12: DRISHMP Vlorë, si institucion i krijuar rishtas prej shkurtit v.2014 ka mangësi të theksuar investimesh e burimesh në pajisje kompjuterike, pajisje e mjete të tjera pune si dhe shoqëruar me to edhe mungesë data base të dhënash nga mungesa e Bashkëpunimit me Ministrinë Mjedisi, ISHP Qendër, ish-MBUMK etj, si dhe mungesë të vendosjes dhe instalimit të sistemeve IT me të dhënat bazë; a. Për DRISHMP Vlorë ndarë: b. Për Pyjet, c. Për Mjedisin, d. Për Fusha të tjera; mungesa e të cilave ndikojnë në përmbushjen e funksionimit të DRISHMP Vlorë *(Trajtuar më hollësisht në faqe 6-8 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 12: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori me strukturat përkatëse, Njësia e Financës dhe Përgjegjësit e Sektorëve, në bashkëpunim me ISHP Qendër Tiranë, të marrin të parashikojnë fond investimesh e burimesh në kërkesat buxhetore projekt buxhetet e viteve 2016 e pasardhës në pajisje kompjuterike, pajisje e mjete të tjera pune, në krijimin e data base të dhënash duke bashkëpunuar me Ministrinë përkatëse të fushave si Ministrinë e Mjedisit, ISHP Qendër, Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural etj, si dhe masat për vendosjen dhe instalimin e sistemeve IT me të dhënat bazë; a. Për DRISHMP Vlorë ndarë: b. Për Pyjet, c. Për Mjedisin, d. Për Fusha të tjera; mungesa e të cilave ndikojnë në përmbushjen e funksionimit të DRISHMP Vlorë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi.

Gjetje 13 : Në DRISHMP Vlorë, sektori Inspektimit në Pyje për periudhën Korrik –Dhjetor 2014, v.2015 dhe 6/Mujori I-rë 2016, nga auditimi me zgjedhje të rastit të 54(13+24 +17), Inspektimeve ose 12 % mbi 472 inspektime të kryera përkatësisht: 125 korrik- dhjetor 2014, për 202 inspektime kryer në vitin 2015 dhe për 145 kryer në 6 mujorin I-rë 2016, rezulton se *ka munguar dhe nuk është hartuar një tabelë e grupimi sintetik i inspektimeve të kryera në sektorin e pyjeve sipas klasifikimit: Inspektime në Zonat e mbrojtura me pyje mbrojtëse a, në vijën bregdetare, b. Në brigjet lumore dhe përrenj me prurje lumore, c. Në zonat e mbrojtura , d. Në pyjet prodhues, në kullota-livadhe, f. Në monumentet e natyrë, g, zona të përziera; klasifikim i cili do të siguronte rritjen e efektivitetit të inspektimeve, përcaktimin e zonave të riskuara dhe përdorimin me efektivitet të kapaciteteve inspektuese, të cilat janë të kufizuara në raport me shtrirjen territoriale të Qarkut Vlorë me vijë të konsiderueshme bregdetare, vijë lumore të disa lumenjve gati 1/3 e Republikës; pasqyruar në tabelën emërtuar “Dinamika e Inspektimeve të kryera dhe Dënimet administrative gjordat e vendosura për vitin 2014, 2015 dhe 6/Mujori I-rë 2016 Tabela nr. 1.” *(Trajtuar më hollësisht në faqe 8-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.*

Rekomandim 13: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, sektori Inspektimit në Pyje të marrin masa të vendosin dhe sistemojnë databasen e të dhënave të **472 inspektimeve** të kryera në Sektorin e pyjeve në periudhën Korrik –Dhjetor 2014, v.2015 dhe 6/Mujori I-rë 2016, (deri tani të munguar dhe pa tabelë grupimi sintetik) sipas klasifikimit: *Inspektime në Zonat e mbrojtura me pyje mbrojtëse a, në vijën bregdetare, b. Në brigjet lumore dhe përrenj me prurje lumore, c. Në zonat e mbrojtura , d. Në pyjet prodhues, në kullota- livadhe, f. Në monumentet e natyrë, g, zona të përziera; klasifikim i cili do të siguronte rritjen e efektivitetit të inspektimeve, përcaktimin e zonave të riskuara dhe përdorimin me efektivitet të kapaciteteve inspektuese, të cilat janë të kufizuara në raport me shtrirjen territoriale të Qarkut Vlorë me përparësi zhvillimin turizmit, me vijë të konsiderueshme bregdetare, vijë lumore të disa lumenjve gati 1/3 e Republikës; pasqyruar në tabelën emërtuar “Dinamika e Inspektimeve të kryera dhe Dënimet administrative gjordat e vendosura për vitin 2014, 2015 dhe 6/Mujori I-rë 2016 Tabela nr. 1”.*

Menjëherë dhe në Vazhdimësi

Gjetje 14: Në DRISHMP Vlorë, sektori Inspektimit në Pyje nga auditimi për mënyrën e planifikimit dhe ekzekutimit të misionit të inspektimeve, rregullshmërinë, ligjshmërinë dhe mbajtjen e dokumentacionit në 54 (13+24 +17) praktika ose 12% të zgjedhura kundrejt **472 inspektimeve** të

kryera në Sektorin e pyjeve në periudhën Korrik –Dhjetor 2014, v. 2015 dhe 6/Mujori I-rë 2016 (përkatësisht 125 korrik-dhjetor 2014, për 202 inspektime në vitin 2015 dhe 145 kryer në 6 mujorin I-rë 2016), rezultojnë 10 praktika të rregullta të 6/mujorit I-rë 2016 dhe 44 **praktika të parregullta** prej të cilave 24 në vitin 2015 dhe 7 në v. 2016 dhe konkretisht me:

Inspektime të mangëta në mosplotësim të qëllimit, jo të plota dhe pa ose me efektivitet të ulët me mos përcaktim të riskut paraprak, me mos planifikimin e programimin, me mangësi në cilësinë e mbajtjes së dokumentacionit, mos identifikimin e subjektit, të veprimtarisë dhe të bazës ligjore menaxhuese të veprimtarisë së fushës, e cila përbën drejtimet kryerjes së misionit të inspektimit, pa identifikim, koordinim e pjesëmarrje të subjekteve administrues si NJQV, apo ish-DSHP, apo Subjekte të tjerë shtetëror publik apo privat që lidhen me veprimtarinë mbi resurset pyjore, kullosore, të Florës, Faunës apo Biodiversitetit.

Dokumentet “Autorizim Inspektimi”, janë të pa plota, pa përshkrime të sakta të rubrikës “Objekti i Inspektimit” lidhur me emërtimin e subjektit, veprimtarinë që ushtron, përcaktimin e bazës ligjore mbi të cilën mbështeten drejtimet e misionit të inspektimit, etj,

Dokumentet “Procesverbale inspektimi”, janë të pa plota jo të përputhura me dokumentin me të dhënat e shprehura në “Autorizim Inspektimi”, pa përcaktim të bazës ligjore, shpesh me detyra të pa përcaktuara sakte ose pa vendosur detyra, me detyra pa afate dhe pa ushtruar kontrollet e zbatimit të tyre në zbatim të afateve të vendosura. Këto mangësi vërehen edhe në sqarimet sipas dokumentit shoqërues “A4”,

Në disa inspektime nuk evidentohet ndjekja e detyrave në periudhë të mëtejme dhe i nuk sigurohet as lidhja shënimi ndërmjet këtij dokumenti me dokumentet eventuale të mbajtura në ndjekje pas 10 ditëshit; mangësi e shkelje këto në mos përmbushje të kërkesave të nenit 45 pikat 1,2,3,4 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12, i ndryshuar, të bazës ligjore e nënligjore menaxhuese mbi të cilat mbështetet kryerja e inspektimeve përkatësisht ligji nr.10120, datë 23.4.2009 “Për Mbrojtjen e Bimëve Mjekësore, Etero vajore Tanifere”, ligji nr. 9693, datë 19.03.2007 “Për Fondin Kullosor” ligjit nr.111/2012, datë 15.11.2012” Për menaxhimin e Integruar të Burimeve ujore“ neni 4, pika 8, neni 84 “Veprimtaritë në Brigje”, Ligjin për zonat e mbrojtura, Parqet kombëtare, pyjet mbrojtëse lumore, për gjuetinë, VKM nr. 391, datë 2006 “Për Tarifat e Shpërblimit të Dëmit në Pyje kullota”, me nenin 8 të ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për Pronat e Paluajtshme të Shtetit”, i ndryshuar, me ligjin nr. 8744, datë 28.02.2001 me VKM nr. 500, datë 14.8.2001 “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme Shtetërore dhe Transferimin e Pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, me Udhëzimin e Ministrisë Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit (MPVD) nr. 3, datë 18.7.2002 “Për Inventarizimin e Pronave të Paluajtshme të Shtetit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore me VKM-të përkatëse të kalimit në pronësi të NJQV-ve, mosarkivimin dhe administrimin e dokumentacionit të inspektimeve, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.01.1993 “Për Arkivat në Republikën e Shqipërisë”, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, ligjin nr. 9936 date 26.06.2008, “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe me VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 8-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 14: DRISHMP Vlorë, sektori Inspektimit në Pyje dhe strukturat përkatëse në kryerjen e inspektimeve të sektorit të Pyjeve të marrin masat në drejtim të plotësimin të misionit dhe qëllimit të inspektimeve, të mënyrës së planifikimit mbështetur në riskun paraprak, të rritjes së efektivitetit në ekzekutimin, cilësinë rregullshmërinë, ligjshmërinë mbajtjes së dokumentacionit, në përmbushje të të qëllimit, rritjes së efektivitetit si dhe masa lidhur me identifikimin e subjektit, të veprimtarisë dhe të bazës ligjore menaxhuese të veprimtarisë së fushës, e cila përbën drejtimet kryerjes së misionit të inspektimit, me identifikimin, koordinimin e pjesëmarrje të subjekteve administrues si NJQV, apo ish-DSHP, apo Subjekte të tjerë shtetëror publik apo privat që lidhen me

veprimtarinë mbi resurset pyjore, kullimore, te Florës, Faunës apo Biodiversitetit, në zbatim të Urdhrit nr. 58/1, datë 22.01.2015 “Për disa shtesa e ndryshime në urdhrin nr.58, datë 21.08.2014 “Për miratimin e Formateve Standard për Dokumentimin e Veprimtarisë së Inspektimit në Republikën e Shqipërisë” dhe të Urdhrit nr.13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, (dokumente këto të dërguara me vonesë me 20. Gusht 2016 nga ISHMP Qendror Tiranë) dhe të bazës ligjore menaxhuese në fushën e mjedisit pyjeve resurseve, me synim përmbushjen e misionit, qëllimit dhe funksioneve të institucionit DRISHMP Vlorë.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi

Gjetje 15: Në DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve nga auditimi rezultoi se dokumentacioni në 54 praktika inspektimesh të përzgjedhura por dhe **472 inspektimeve** të kryera në periudhën Korrik–Dhjetor 2014, v.2015 dhe 6/Mujori I-rë 2016 është e pa inventarizuar fletë për fletë, pa fletën përkatëse të inventarit me firma të këmbëzues-marrës dorëzim dhe i pa dorëzuar në arkiv, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.01.1993 “Për Arkivat në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 8-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 15: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve dhe strukturat përkatëse të marrin masa të krijojnë databaze përkatëse, të inventarizojnë fletë për fletë, hartojnë fletën përkatëse të inventarit me firma të këmbëzues-marrës dorëzim dhe të dorëzojnë në arkiv dokumentacionin e **472 inspektimeve** të kryera në periudhën Korrik–Dhjetor 2014, v.2015 dhe 6/Mujori I-rë 2016, në zbatim ligjin nr. 9154, datë 06.01.1993 “Për Arkivat në Republikën e Shqipërisë.

Menjëherë

Gjetje 16: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve, sipas praktikës e dokumentacionit ka kryer inspektim nr. 465, datë 15.10 2014 në subjektin “E KSh G” cila nga auditimi është gjetur praktikë inspektimi me dokumentacion të paqartë e jo paplotë, paqartë dhe pa funksion pa masa e detyra, në kundërshtim me nenin 45 pikat 1,2,3,4, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në mos përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 23.04.2009 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12(*Trajtuar më hollësisht në faqe 8-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 16: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve për praktika të parregullta në inspektimet e audituara dhe të gjetura pa efektivitet dhe pa përmbushje të qëllimit dhe me mangësi në dokumentacion, si dhe nisur nga rëndësia që paraqesin resurset dhe nga prania e interesave lidhur me statusin juridik publik e Lokal, të planifikojnë e rinisin Inspektimet përkatësisht për inspektim nr. 465, datë 15.10 2014 në subjektin “E K S G, duke zbatuar procedurat, hartuar dokumentacionin sipas dhe në zbatim të Urdhrit nr.58/1, datë 22.01.2015 “Për disa shtesa e ndryshime në urdhrin nr. 58, datë 21.08.2014 “Për miratimin e Formateve Standard për Dokumentimin e Veprimtarisë së Inspektimit në Republikën e Shqipërisë” dhe të Urdhrit nr. 13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”(dokumente këto të dërguara me vonesë me 20. Gusht 2016 nga ISHMP Qendror Tiranë) dhe të bazës ligjore menaxhuese në fushën e mjedisit pyjeve resurseve.

Brenda 3/mujorit të I-rë 2017

Gjetje 17: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve, sipas praktikës e dokumentacionit ka kryer me Autorizim inspektimi nr. 193 datë 7.04.2015 në subjektin “Parku i Butrintit” e cila nga auditimi është gjetur praktikë inspektimi me dokumentacion të paqartë e jo paplotë, pa funksion pa masa e detyra, pasi:

Në Procesverbal inspektimi nr. Serie 20131, datë 7.04.2015, lihen detyra duke kërkuar informacion për personin i cili ka hapur gropa për mbjellje pemësh në sipërfaqen e Parkut.

Këto detyra janë të pa mjaftueshme sepse nuk lëne afat, dhe nisur nga rëndësia unikalë e këtij parku, duhej drejtuar e kërkuar bashkëpunim edhe me organet e rendit për të bërë identifikimin e personit; si dhe nuk ka gjurme bashkëlidhje dokumentacioni për vazhdimin e plotësimin e këtij inspektimi; Pra inspektim me nivel të ulët efektiviteti; gjendje kjo në kundërshtim me nenin 45 pikat 1,2,3,4 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në mos përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 23.04.2009 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12 si dhe me aktet ligjore të Parqeve kombëtare etj (*Trajtuar më hollësisht në faqe 8-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 17: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve për praktika të parregullta në inspektimet e audituara dhe të gjetura pa efektivitet dhe pa përmbushje të qëllimit dhe me mangësi në dokumentacion, si dhe nisur nga rëndësia që paraqesin resurset nga prania e interesave lidhur me statusin juridik publik e Unikal, të planifikojnë e rinisin Inspektimet përkatësisht për inspektimin nr. 193 datë 7.04.2015 në subjektin “Parku i Butrintit”, duke zbatuar procedurat, hartuar dokumentacionin sipas dhe në zbatim të Urdhrit nr. 58/1, datë 22.01.2015 “Për disa shtesa e ndryshime në urdhrin nr. 58, datë 21.08.2014 “Për miratimin e Formateve Standard për Dokumentimin e Veprimtarisë së Inspektimit në Republikën e Shqipërisë” dhe të Urdhrit nr.13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”,(dokumente këto të dërguara me vonesë me 20 Gusht 2016 nga ISHMP Qendror Tiranë) dhe të bazës ligjore menaxhuese në fushën e mjedisit pyjeve resurseve.

Brenda 3/mujorit të I-rë 2017

Gjetje 18: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve, sipas praktikës e dokumentacionit ka kryer me Autorizim inspektimi nr. 262, datë 08.06.2015 dhe nr. 229, datë 06.05.2015 në subjektin “Ekonomia Pyjore ana e lumit Vjosë, me statusin Zonë e Mbrojtur dhe status Pyje me Funkcion Mbrojtës”, të cilat nga auditimi janë gjetur praktika inspektimi me dokumentacion të paqartë e jo paplotë, pa funksion pa masa e detyra, pasi:

Objekti i inspektimit “verifikimi dhe azhurnimi i sipërfaqeve në parcelën nr. 14 të EP “Ana e Lumit Vjose”, nuk është i plotë pasi nuk përcakton bazën ligjore menaxhuese, statusin funksional, juridik pronësor etj. Që do të shërbenin si drejtime kryesore të kryerjes së misionit zaptimin e sipërfaqes prej 42400 m² tokë arë, për të cilën gjithashtu nuk shprehet pronësia e kësaj toke të zaptuar, përfshirja në cilin ndodhet, nuk rekomandohet asnjë lloj detyre, mase bashkëpunuese me NjQV, organet e rendit; si dhe nuk ka verifikim të fondit kadastral të tokës nëse është tokë bujqësore trajtuar nga ligji nr. 7501; pra inspektimi është i pa plotë, pa funksion dhe në kundërshtim me nenin 45 pikat 1,2,3,4 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në mos përmbushje të kërkesave të ligjit nr. 9385, datë 23.04.2009 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12. Ligjin për zonat e mbrojtura, Parqet kombëtare, pyjet mbrojtëse lumore (*Trajtuar më hollësisht në faqe 8-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 18: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve për praktika të parregullta në inspektimet e audituara dhe të gjetura pa efektivitet dhe pa përmbushje të qëllimit dhe me mangësi në dokumentacion, si dhe nisur nga rëndësia që paraqesin resurset nga prania e interesave lidhur me statusin juridik publik e Unikal, të planifikojnë e rinisin Inspektimet përkatësisht për inspektimet nr. 262, datë 08.06.2015 dhe nr. 229, datë 06.05.2015 në subjektin “Ekonomia Pyjore ana e lumit Vjosë, me statusin Zonë e Mbrojtur dhe status Pyje me Funkcion Mbrojtës”, duke zbatuar procedurat, hartuar dokumentacionin sipas dhe në zbatim të Urdhrit nr. 58/1, datë 22.01.2015 “Për disa shtesa e ndryshime në urdhrin nr. 58, datë 21.08.2014 “Për miratimin e Formateve Standard për Dokumentimin e Veprimtarisë së Inspektimit në Republikën e Shqipërisë” dhe të Urdhrit nr. 13, datë 23.04.2015“Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e

Shqipërisë”,(dokumente këto të dërguara me vonesë me 20 Gusht 2016 nga ISHMP Qendror Tiranë) dhe të bazës ligjore menaxhuese në fushën e mjedisit pyjeve resurseve.

Brenda 3/mujorit të I-rë 2017

Gjetje 19: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve, sipas praktikës e dokumentacionit ka kryer inspektim me Autorizim inspektimi nr. 32, datë 10.3.2016 në subjektin “Ekonomia Pyjore Selenicë“, me objekt “kontroll se në parcelat ndërmjet Romësit dhe Resulajt ka zaptime të Fondit Pyjor” e cila nga auditimi është gjetur praktikë inspektimi me dokumentacion të paqartë të paplotë, pa funksion dhe pa masa e detyra, pasi:

Në Autorizim Inspektimi nr. 32, datë 10.3.2016, “Objekti i Inspektimit”, nuk përcaktohet baza ligjore menaxhuese mbi të cilat do të drejtohet misioni i inspektimit, që në këtë rast do të ish ligjet për pyjet etj, dhe nuk përcaktohet subjekti administrues i sipërfaqeve pyjore (NJQV apo DSHP),

Në Procesverbal inspektimi nr. Serie 15866, datë 10.3.2016, është i përgjithshëm i pa qartë dhe nuk i përmbahet apo nuk përmend objektin e inspektimit, si dhe mungojnë kontaktimet apo pjesëmarrja e përfaqësuesve të NJQV-së, në kundërshtim me nenin 45 pikat 1,2,3,4 të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqe 8-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 19: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve për praktika të parregullta në inspektimet e audituara dhe të gjetura pa efektivitet dhe pa përmbushje të qëllimit dhe me mangësi në dokumentacion, si dhe nisur nga rëndësia që paraqesin resurset nga prania e interesave lidhur me statusin juridik publik e Unikal, të planifikojnë e rinisin Inspektimet përkatësisht për inspektimin nr. 32, datë 10.3.2016 në subjektin “Ekonomia Pyjore Selenicë“, me objekt “kontroll në parcelat ndërmjet Romësit dhe Resulajt ka zaptime të Fondit Pyjor” në subjektin, duke zbatuar procedurat, hartuar dokumentacionin sipas dhe në zbatim të Urdhrit nr. 58/1, datë 22.01.2015 “Për disa shtesa e ndryshime në urdhrin nr.58, datë 21.08.2014 “Për miratimin e Formateve Standard për Dokumentimin e Veprimtarisë së Inspektimit në Republikën e Shqipërisë” dhe të Urdhrit nr.13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”,(dokumente këto të dërguara me vonesë me 20. Gusht 2016 nga ISHMP Qendror Tiranë) dhe të bazës ligjore menaxhuese në fushën e mjedisit pyjeve resurseve.

Brenda 3/mujorit të I-rë 2017

Gjetje 20: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve, sipas praktikës e dokumentacionit ka kryer inspektim me Autorizim inspektimi nr. 65, datë 13.06.2016 në subjektin “Ekonomia Pyjore Kotë-Sevaster“, me objekt kontrolli“ për prerje zaptime si dhe veprimtari që bien ndesh me ligjin nr.9385..., “ e cila nga auditimi është gjetur praktikë inspektimi me dokumentacion të paqartë e jo paplotë, pa funksion pa masa e detyra, pasi:

Në Autorizim Inspektimi nr. 65, datë 13.06.2016 “Objekti i Inspektimit”, përcaktohet baza ligjore menaxhuese mbi të cilat do të drejtohet misioni i inspektimit, por nuk përcakton subjektin me përgjegjësi administrues menaxhues,

Në Procesverbal inspektimi nr. 15878, datë 13.06.2016 shprehet se është shpyllëzuar sipërfaqja pre 2400 m² me mjete të mekanizuara dhe 2 sipërfaqe të tjera me nga 600 m² secila , sipërfaqe këto të punuara me traktor por nuk vërehet fenomeni i shpyllëzimit, dyshohet se këto sipërfaqe përdoren për aktivitet të paligjshëm. Dhe në relacionin A4 shprehet se do të mbahet në mbikëqyrje kjo sipërfaqe.

Është njoftuar me shkresë Bashkia Selenicë;me shkresën nr. 132, datë 23.06.2016 por nuk ka një detyrë kundrejt Bashkisë Selenice për marrjen nën administrim nga NJQV nxjerrjen e përgjegjësise ndaj saj për mos ushtrim të kontrollit të territorit të saj, me pasojë dëmtim shpyllëzim të sipërfaqes pyjore; si dhe deri në momenti datë 21. Nëntor 2016, pra prej 5 muajsh nuk ka një verifikim të

zbatimit të detyrave apo të gjendjes aktuale reale; gjendje kjo në mos përmbushje të kërkesave të nenin 45,pikat 1,2,3,4, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”dhe ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 12, i ndryshuar (*Trajtuar më hollësisht në faqe 8-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 20: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve për praktika të parregullta në inspektimet e audituara dhe të gjetura pa efektivitet dhe pa përmbushje të qëllimit dhe me mangësi në dokumentacion, si dhe nisur nga rëndësia që paraqesin resurset nga prania e interesave lidhur me statusin juridik publik e Lokal, të planifikojnë e rinis Inspektimin përkatësisht për inspektimin nr. 65, datë 13.06.2016 në subjektin “Ekonomia Pyjore Kotë-Sevaster“,me objekt kontrolli “ për prerje zaptime si dhe veprimtari që bien ndesh me ligjin nr. 9385..., duke zbatuar procedurat, hartuar dokumentacionin sipas dhe në zbatim të Urdhrit nr.58/1, datë 22.01.2015 “Për disa shtesa e ndryshime në urdhrin nr.58, datë 21.08.2014 “Për miratimin e Formateve Standard për Dokumentimin e Veprimtarisë së Inspektimit në Republikën e Shqipërisë” dhe të Urdhrit nr.13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”,(dokumente këto të dërguara me vonesë me 20 Gusht 2016 nga ISHMP Qendror Tiranë) dhe të bazës ligjore menaxhuese në fushën e mjedisit pyjeve resurseve.

Brenda 3/mujorit të I-rë 2017

Gjetje 21: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve, sipas praktikës e dokumentacionit ka kryer inspektim me Autorizim inspektimi nr. 62, datë 06.06.2016, në subjektin “Ekonomia Pyjore Selenicë Parcela 16,17,18“, me objekt “Sipas Informacionit të Bashkisë” (me kërkesë DRISHMP Vlorë me shkresën nr. 50/2. Datë 06.04.2016, përgjigjen nr. 783, datë 29.04.2016 nga Bashkia Selenicë ku renditen 32 persona me sipërfaqe 185 900 m²,ose 18,59 ha marre me qira nga bashkia Selenice për kultivim prej të cilëve 31 persona me sipërfaqen 183400m² ose 18,34 ha me bime 1 vjeçare grurë jonxhe etj dhe 1 person për sipërfaqen 2500m² ose 0,25 ha ullishtë, praktikë e cila nga auditimi është gjetur praktikë inspektimi me dokumentacion të paqartë e jo paplotë, pa funksion pa masa e detyra, pasi:

Pas kryerjes procedurës inspektimit DRISHMP Vlorë me shkresën nr.132/1, datë 23.06.2016 ka kërkuar “Bashkia të shprehet për ndjekjen e hapave të duhur ligjor për tjetërsimin e këtij fondi, apo dhënien në përdorim të këtyre sipërfaqeve...”

Ky përfundim inspektimi nuk është i plotë e funksional pasi; Grupi i inspektimit nuk është thelluar në këtë inspektim dhe nuk ka kërkuar shqyrtuar lidhur me vendndodhjen buzë lumit Vjosë si dhe lidhur me çështjet kohë zgjatjen e kontratave, identifikohet zëri kadastral i origjinës, vlerësohet vendndodhja dhe distancat nga buza e lumit Vjosë sipas ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012” Për menaxhimin e Integruar të Burimeve ujore “ duke respektuar neni 4, pika 8, neni 84 “Veprimtaritë në Brigje”, për të siguruar statusin e zonave të mbrojtjes buzë lumenjve”

DRISHMP Vlorë duhej të ri shqyrtonte e rikryente këtë grup inspektimesh, duke evidentuar kohë zgjatjen e kontratave, identifikohet zëri kadastral i origjinës, vlerësohet vendndodhja dhe distancat nga buza e lumit Vjosë sipas ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012” Për menaxhimin e Integruar të Burimeve ujore“ duke respektuar neni 4, pika 8, neni 84 “Veprimtaritë në Brigje”(Trajtuar më hollësisht në faqe 8-29 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 21: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve për praktika të parregullta në inspektimet e audituara dhe të gjetura pa efektivitet dhe pa përmbushje të qëllimit dhe me mangësi në dokumentacion, si dhe nisur nga rëndësia që paraqesin resurset nga prania e interesave lidhur me statusin juridik publik e Lokal, të planifikojnë e rinis Inspektimin përkatësisht për inspektimin nr. 62, datë 06.06.2016, në subjektin “Ekonomia Pyjore Selenicë Parcela 16,17,18“ si dhe të ri shqyrtohen e kryhen ky grup inspektimesh, duke evidentuar kohë zgjatjen e kontratave, identifikohet zëri kadastral i origjinës, vlerësohet vendndodhja dhe distancat nga buza e lumit Vjosë sipas ligjit nr. 111/2012, datë 15.11.2012” Për menaxhimin e Integruar të Burimeve ujore“

duke respektuar neni 4, pika 8, neni 84 “Veprimtaritë në Brigje”, duke hartuar dokumentacionin sipas dhe në zbatim të Urdhrit nr.58/1, datë 22.01.2015 “Për disa shtesa e ndryshime në urdhrin nr.58, datë 21.08.2014 “Për miratimin e Formateve Standard për Dokumentimin e Veprimtarisë së Inspektimit në Republikën e Shqipërisë” dhe të Urdhrit nr.13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”,(dokumente këto të dërguara me vonesë me 20. Gusht 2016 nga ISHMP Qendror Tiranë) dhe të bazës ligjore menaxhuese në fushën e mjedisit pyjeve resurseve.

Brenda 3/mujorit të I-rë 2017

Gjetje 22: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve, për periudhën *viti 2014, 2015 dhe 6/mujorin e I-rë 2016*, ka vonesa dhe moszbatim të *procedurave ligjore te ekzekutimit dhe arkëtimit të gjobave nga masat për dënimet administrative me gjobe për kundravajtjet në inspektimin e sektorit të pyjeve konkretisht: të 75 masa gjobe në vlerën 5,263 mijë lekë, nga të cilat: 19 me vlerë 1,370 mijë lekë në v.2014, në vitin 2015 për 23 gjoba me vlerë 1,345 mijë lekë dhe 33 gjoba me vlerën 2,548 mijë lekë për 6/mujorin e I-rë 2016, ka nivel të ulët të vjeljes së gjobave të vendosura, janë arkëtuar vetëm 3 gjoba me 90 mijë lekë ose 1,7% ; ka vonesa për vitin 2014*, sipas rreshti 3 të tabelës, vonesë prej v. 14 në 2016 për 3 gjoba me 170 mijë lekë, gjithashtu për 12 gjoba me 810 mijë lekë të v. 2014 vendimet janë marrë me afërsisht 2 vjet vonesë dhe për 7 gjoba me vlerë 560 mijë lekë vonesa është 1 vit; *për vitin 2015* për 22 gjobat me vlerë 1,315 mijë lekë procedurat janë me vonesë deri 1 vit pra në v. 2016, për të cilat mban përgjegjësi ish juristi z. *E H*, dorëhequr 30.10.2015 dhe liruar nga detyra me 13.11.2015; si dhe ka vonesë prej 2-8 muaj në procesin e shqyrtimit të ankesave Komisioni i ISHMP Qendër për 20 gjoba në vlerën 1,470 mijë lekë, që i përkasin 6 mujorit I-rë 2016 si dhe ka *mungesë të evidencimit, kontabilizimit dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit të ecurisë së procedurave* ligjore dhe administrative-gjyqësor, në kundërshtim me afatet përcaktuar në KPA; mos regjistrim, kontabilizim në kontabilitet sipas parimit të kontabilitetit “të drejtat e konstatuara”,dhe mos vendosje e mekanizmave të kontrollit të brendshëm lidhur me mos evidentimin rakordimin dhe grupimin sipas ecurisë së procesit të zbatimit të procedurave dhe trajtimin e dokumenteve “Vendime për dënimin administrativ”, në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”, ligjit nr. 9385, datë 23.04.2009 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 38, 40 dhe neni 40/2., ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat financiare” dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, UMF nr. 30, datë 29.12.2011”Për menaxhimin e Aktiveve në sektorin publik”, pasqyruar në tabelën emërtuar “**Vjelja e gjobave dhe ecuria e procesit administrativo gjyqësor Sektori i Pyjeve DRISHMP Vlorë, periudha v. 2014-6/Mujori I-rë 2016 Tabela nr. 4**” nxjerrë grupuar e sistemuar gjatë procesit të auditimit, nga tabelat analitike emërtuar “**Sektori Pyjor Gjoba 2014, 2015, 6/Mujori I-rë 2016**” dhe VKM nr. 103, datë 04.02.2015 “Për Krijimin dhe Mënyrën e Organizimit e të Funkcionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”(Trajtuar më hollësisht në faqe 29-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 22: DRISHMP Vlorë, Sektori Inspektimit të Pyjeve, Juristi të marrin masa të hartojnë program të posaçëm për *zbatimin e procedurave ligjore te ekzekutimit dhe arkëtimit të gjobave të vendosura* për periudhën *viti 2014, 2015 dhe 6/mujorin e I-rë 2016 nga kundravajtjet në inspektimin e sektorit të pyjeve konkretisht: të 75 gjobave në vlerën 5,263 mijë lekë, nga të cilat: 19 me vlerë 1,370 mijë lekë në v.2014, në vitin 2015 për 23 gjoba me vlerë 1,345 mijë lekë dhe 33 gjoba me vlerën 2,548 mijë lekë për 6/mujorin e I-rë 2016, të marrin masa për eliminimin vonesave evidentuar për vitin 2014* sipas rreshti 3 të tabelës vonesë prej v. 14 në 2016 për 3 gjoba me 170 mijë lekë, për 12 gjoba me 810 mijë lekë të v. 2014 vendimet janë marrë me afërsisht 2 vjet vonesë dhe për 7 gjoba me vlerë 560 mijë lekë vonesa është 1 vit; *për vitin 2015* për 22 gjobat me vlerë 1,315 mijë lekë procedurat me vonesë deri 1 vit pra në v. 2016, si dhe për 20 gjoba në vlerën

1,470 mijë lekë që i përkasin 6/mujorit I-rë 2016 të vonuara 2-8 muaj në procesin e shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i ISHMP Qendër në kundërshtim me afatet përcaktuar në KPA, pasqyruar në tabelën emërtuar **“Vjelja e gjobave dhe ecuria e procesit administrativo gjyqësor Sektori i Pyjeve DRISHMP Vlorë, periudha v. 2014-6/Mujori I-rë 2016 Tabela nr. 4”** nxjerrë grupuar e sistemuar gjatë procesit të auditimit nga tabelat analitike emërtuar **“Sektori Pyjor Gjoba 2014, 2015, 6/Mujori I-rë 2016”**.

Menjëherë brenda 3/Mujorit I-rë 2017

Gjetje 23: DRISHMP Vlorë dhe ISHPM Qendër Tiranë për **20 gjoba në vlerën 1,470 mijë lekë** që i përkasin 6/mujorit I-rë 2016 kanë vonuar 2-8 muaj në procesin e shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i ISHMP Qendër, në kundërshtim me afatet përcaktuar në KPA; gjendje kjo në kundërshtim të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011”Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, **ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”** të ligjit nr. 9385, datë 23.04.2009 “Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor”, neni 38, 40 dhe neni 40/2 pasqyruar sipas rreshtit nr. 8 në tabelën emërtuar **“Vjelja e gjobave dhe ecuria e procesit administrativo gjyqësor Sektori i Pyjeve DRISHMP Vlorë, periudha v. 2014-6/Mujori I-rë 2016 Tabela nr. 4”** (Trajtuar më hollësisht në faqe 29-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 23: DRISHMP Vlore dhe ISHPM Qendër Tiranë të marrin masa të menjëhershme për përfundimin e procedurave të shqyrtimit për **20 gjoba në vlerën 1,470 mijë lekë** që i përkasin 6/mujorit I-rë 2016 të vonuara 2-8 muaj në procesin e shqyrtimit të ankesave nga Komisioni i ISHMP Qendër, në kundërshtim me afatet përcaktuar në KPA.

Menjëherë brenda Dhjetor 2016

Gjetje 24: DRISHMP Vlorë, Njësia e Financës dhe Juristi kanë pamjaftueshmëri pune, mungesë performace, mungesë bashkëpunimi lidhur me mos vendosjen e mekanizmave të kontrollit të brendshëm dhe mos evidentimin rakordimin dhe grupimin sipas ecurisë së procesit të zbatimit të procedurave dhe trajtimin e dokumenteve “Vendime për dënimin administrativ”, sipas formatit të tabelës emërtuar **“Vjelja e gjobave dhe ecuria e procesit administrativo gjyqësor Sektori i Pyjeve DRISHMP Vlorë, periudha v. 2014-6/Mujori I-rë 2016 Tabela nr. 4”**, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 **“Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”**, dhe UMF nr. 30, datë 29.12.2011”Për menaxhimin e Aktiveve në sektorin publik” (Trajtuar më hollësisht në faqe 29-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 24: DRISHMP Vlorë, Njësia e Financës me Juristin të marrin masa në bashkëpunim të vendosin Sistemin e Mekanizmave të Kontrollit të Brendshëm (SMKB), të trajtojnë dokumentacionin e procedurën e gjobave si letra me vlerë, për këtë të ndjekin procesin e veprimeve sipas procedurave, të evidentojnë, rakordojnë dhe grupojnë sipas ecurisë së procesit të zbatimit të procedurave dhe trajtimin e dokumenteve “Vendime për dënimin administrativ”, sipas formatit të tabelës emërtuar **“Vjelja e gjobave dhe ecuria e procesit administrativo gjyqësor Sektori i Pyjeve DRISHMP Vlorë, periudha v. 2014-6/Mujori I-rë 2016 Tabela nr. 4”**.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi

Gjetje 25: DRISHMP Vlorë, Njësia e Financës me Juristin pamjaftueshmëri pune, mungesë performace mungesë bashkëpunimi lidhur me mos vendosjen e (SMKB), mos evidentimin rakordimin dhe grupimin sipas ecurisë së procesit të zbatimit të procedurave dhe trajtimin e dokumenteve “Vendime për dënimin administrativ” që kanë sjellë si pasojë mos përfshirjen në kontabilitet, mos regjistrimin sipas parimit të kontabilitetit “të drejtat e konstatuara” **të 75 gjobave në vlerën 5,263 mijë lekë, nga të cilat: 19 me vlerë 1,370 mijë lekë në v. 2014, në vitin 2015 për 23 gjoba me vlerë 1,345 mijë lekë dhe 33 gjoba me vlerën 2,548 mijë lekë për 6/mujorin e I-rë 2016**, mosveprime në kundërshtim me ligjin nr. 9228, datë 24.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat

financiare”, me ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për Kundravajtjet Administrative”, me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “**Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin**”, UMF nr. 30, datë 29.12.2011”Për menaxhimin e Aktiveve në sektorin publik”(Trajtuar më hollësisht në faqe 29-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 25: DRISHMP Vlorë, Njësia e Financës të marrë masa, evidentojë sipas procesit, të çelë llogaritë përkatëse, të regjistrojë në kontabilitet sipas parimit të kontabilitetit “të drejtat e konstatuara” **të 75 gjobave në vlerën 5,263 mijë lekë, nga të cilat: 19 me vlerë 1,370 mijë lekë në v. 2014, në vitin 2015 për 23 gjoba me vlerë 1,345 mijë lekë dhe 33 gjoba me vlerën 2,548 mijë lekë për 6/mujorin e I-rë 2016**, si dhe në periudha të caktuara të rakordojë me Ministrinë e Mjedisit llogarinë e vlerës së gjobave të likuiduara nga kreditorët përkatës si dhe ti pasqyrojë e raportojë veprimet dhe pozicionet e llogarive në Pasqyrat Financiar përkatëse vjetore dhe periodike.

Menjëherë dhe në Vazhdimësi

Gjetje 26: DRISHMP Vlorë gjatë veprimtarisë 2 vjeçare 2014-30.06.2016 prej krijimit, ka pamjaftueshmëri në përmbushje të funksioneve, lidhur me menaxhimin e inspektimeve vendosjen dhe zbatimin e standardeve, me përgatitjen dhe planifikimin të inspektimit, me dokumentimin e procesit dhe me kontrollin e zbatimit të detyrave (rekomandimeve) si fazë e ndërmjetme para ekzekutimit të masave dënuese dhe sekuestruese zbatuar në Sektorin e Pyjeve pasi:

a. Me emale datë 26 Gusht 2016 në adresë të z. Gj M janë dërguar ;

a.1. Urdhri nr.58/1, datë 22.01.2015 “Për disa shtesa e ndryshime në urdhrin nr. 58, datë 21.08.2014 “Për miratimin e Formateve Standard për Dokumentimin e Veprimtarisë së Inspektimit në Republikën e Shqipërisë”,

a.2. Urdhri nr.13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”.

b.Me emale datë 13 Tetor 2016 në adresë të z. Gj M (dhe gjithë qarqeve), janë dërguar;

b.1.Shkresa nr.6809, datë 12.09.2016 “Për hartimin e Regjistrit të subjekteve të pajisura me Leje Mjedisore”.

b.2.Shkresa nr.6810, datë 12.10.2016 “Për Planifikimin dhe Raportimin Mujor të Inspektimeve”.

b.3.Urdhri nr.6, datë 19.2.2016 “Për Miratimin e Rregullave të Përgjithshme Bazë mbi Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut”.

Të gjitha këto urdhra dhe urdhëresa e shkresa megjithëse të vonuara nuk kanë gjetur zbatim për periudhën e audituar dhe kanë sjellë si pasojë pamjaftueshmërinë në zbatimin e masave për rritjen e shkallës së efektivitetit të Inspektimeve lidhur me riskun, planifikimin, bazën ligjore, caktimin e drejtimeve të misionit të inspektimeve, hartimin e dokumentacionit, vendosjen e detyrave dhe rekomandimeve si dhe kontrollin e zbatimit të tyre kanë pra me ndikim të mos përmbushjes së funksioneve të DRISHMP Vlorë (Trajtuar më hollësisht në faqe 31-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 26: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, strukturat përkatëse të marrin masa për zbatimin e Urdhrit nr.13, datë 23.04.2015 “Për miratimin e Manualit të Përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, Urdhrit nr. 6, datë 19.2.2016 “Për Miratimin e Rregullave të Përgjithshme Bazë mbi Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut”, Urdhrit nr.58/1, datë 22.01.2015 “Për miratimin e Formateve Standard për Dokumentimin e Veprimtarisë së Inspektimit në Republikën e Shqipërisë”, “Për hartimin e Regjistrit të subjekteve të pajisura me Leje Mjedisore”, “Për Planifikimin dhe Raportimin Mujor të Inspektimeve”; urdhra e udhëzime këto megjithëse të dërguara me vonesë, nuk kanë gjetur zbatim për periudhën e audituar dhe kanë sjellë si pasojë pamjaftueshmërinë në zbatimin e masave për rritjen e shkallës së efektivitetit të Inspektimeve lidhur me riskun, planifikimin, bazën ligjore, caktimin e drejtimeve të misionit të inspektimeve, hartimin e dokumentacionit, vendosjen e detyrave dhe rekomandimeve si dhe kontrollin e zbatimit të tyre me synim të përmbushjes së funksioneve të DRISHMP Vlorë lidhur me menaxhimin e inspektimeve

vendosjen dhe zbatimin e standardeve, me përgatitjen dhe planifikimin të inspektimit, me dokumentimin e procesit dhe me kontrollin e zbatimit të detyrave (rekomandimeve) si fazë e ndërmjetme para ekzekutimit të masave dënuese dhe sekuestruese zbatuar në Sektorin e Pyjeve.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje 27: DRISHMP Vlorë, në periudhën 2014-6/Mujori I-rë 2016, nuk ka parashikuar, planifikuar e nuk ka kryer asnjë dokumentim inspektimi tematike zonale apo me objekt të individualisht të caktuar për inspektimin e monumenteve të natyrës shqiptare si një resurs i madh me funksion nxitës për turizmin që në juridiksionin e territorin e Qarkut Vlorë ato përbëjnë një numër të tota prej mbi 24 objekte të shpërndarë në Qark ku përmendim në **Vlorë 15 objekte** emërtuar: 1. Lisat e Pilurit, 2. Ilqet e Zarelit, 3. Kanioni i Gjipese, 4. Bokërimat e Vunoit, 5. Laguna e Linpoit, 6. Rrepet e Buronjave, 7. Pisha flamur, 8. Rrugët e Bardha + Delta e përroit, 9. Shpella e Piratëve Dhërmi, 10. Shpella e Surjanit Gjile Himarë, 11. Shpella e Porto Palermos, 12. Qiparizi i Kambanores Vuno, 13. Rrapi i Palasës, 14 Rrapi i Kosmarit Kudhës, 15. Pylli i Zverneçit; në **Sarandë 4 objekte** emërtuar: 1. Kanioni Leshnice, 2. Gjiri i Kakomese, 3. Pylli i Butrintit, 4. Ishujt e Ksamilit; në Delvinë 5 objekte emërtuar: 1. Pylli i Lefkës, 2. Pylli i Busheçit, 3. Valanidhet e Dhrovjanit, 4. Burimi i Oknos, 5. Syri i Kaltër shpallur sipas VKM nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës Shqiptare", dhe gjithashtu për Njësitë administruese ka qenë detyrë ndarja dhe evidentimi i tyre sipas përkatësisë së vendndodhjes sipas ekonomive pyjore, ngastrave si dhe përfshirja e tyre në planet e menaxhimit mbarështimit si në planin e shpenzimeve ashtu dhe të vendosjes e administrimit të të ardhurave prej vizitorëve turistik, si dhe detyra tjetër nisja dhe përfundimi i procedurave për propozimin e përfshirjen në zgjerimin e kësaj liste dhe me disa objekteve për vënien në mbrojtje dhe evidentimin e nxjerrjen në pah të vlerave turistike të tyre. Këto objekte janë: Shkëmbi i Qeparoit të Sipërm, Gryka e Dhërmiut, Gadishulli i Kalasë në Porto Palermo, dhe Shpella e Hunit në Gjilek Dhërmi; gjendje kjo në kundërshtim me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 "Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë", **ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative"** të ligjit nr. 9385, datë 23.04.2009 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor", neni 38, 40 dhe neni 40/2 dhe me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "**Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin**", UMF nr. 30, datë 29.12.2011 "Për menaxhimin e Aktiveve në sektorin publik" (*Trajtuar më hollësisht në faqe 31-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 27: DRISHMP Vlorë, të marrë masa të parashikojë, planifikojë në planet vjetore e periodike të inspektimeve, të kryejë e dokumentojë inspektime tematike zonale apo me objekt individualisht të caktuar të monumenteve të natyrës shqiptare si një resurs i madh me funksion nxitës për turizmin që në juridiksionin e territorin e Qarkut Vlorë ato përbëjnë një numër të total prej mbi 24 objekte të shpërndarë në Qark ku përmendim në **Vlorë 15 objekte** emërtuar: 1. Lisat e Pilurit, 2. Ilqet e Zarelit, 3. Kanioni i Gjipese, 4. Bokërimat e Vunoit, 5. Laguna e Linpoit, 6. Rrepet e Buronjave, 7. Pisha flamur, 8. Rrugët e Bardha + Delta e përroit, 9. Shpella e Piratëve Dhërmi, 10. Shpella e Surjanit Gjile Himarë, 11. Shpella e Porto Palermos, 12. Qiparizi i Kambanores Vuno, 13. Rrapi i Palasës, 14 Rrapi i Kosmarit Kudhës, 15. Pylli i Zverneçit; në **Sarandë 4 objekte** emërtuar: 1. Kanioni Leshnice, 2. Gjiri i Kakomese, 3. Pylli i Butrintit, 4. Ishujt e Ksamilit; në Delvinë 5 objekte emërtuar: 1. Pylli i Lefkës, 2. Pylli i Busheçit, 3. Valanidhet e Dhrovjanit, 4. Burimi i Oknos, 5. Syri i Kaltër shpallur sipas VKM nr. 676, datë 20.12.2002 "Për shpalljen zonë e mbrojtur të monumenteve të natyrës Shqiptare"; si dhe të përfshijë në këto inspektime edhe detyrimet për Njësitë administruese lidhur me ndarjen dhe evidentimi i tyre sipas përkatësisë së vendndodhjes sipas ekonomive pyjore, ngastrave si dhe përfshirja e tyre në planet e menaxhimit mbarështimit si në planin e shpenzimeve ashtu dhe të vendosjes e administrimit të të ardhurave prej vizitorëve turistik, si dhe detyra tjetër nisja dhe përfundimi i procedurave për propozimin e përfshirjen në zgjerimin e kësaj liste dhe me disa objekteve për vënien në mbrojtje dhe evidentimin e nxjerrjen në

pah të vlerave turistike të tyre. Këto objekte janë: Shkëmbi i Qeparoit të Sipërm, Gryka e Dhërmiut, Gadishulli i Kalasë në Porto Palermo, dhe Shpella e Hunit në Gjilek Dhërmi;

Menjëherë dhe në vazhdimësi

Gjetje 28 : Nga DRISHMP Vlorë nuk është kryer inventarizimi i pronës për vitin 2014-2015. Konkretisht nga Drejtoria duhet të formulohej Urdhër i brendshëm për krijimin e komisionit të inventarizimit të vlerave materiale dhe fillimin e procedurës së inventarizimit në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 20, datë 17.11.2014. në Urdhër duhet të përcaktohej Komisioni i inventarizimit i përbërë nga jo me pak se 3 veta, kryetar, dhe dy anëtar. Gjatë kryerjes së inventarit komisioni mban procesverbalet përkatëse sipas objekteve të inventarit dhe njëkohësisht kur konstaton se artikuj të ndryshëm janë në gjendje të papërdorshme për efekt të konsumit fizik e moral të tyre harton listën e inventarëve dhe propozon ngritjen e komisionit të vlersimit i cili propozon për nxjerrje jashtë përdorimit artikuj të ndryshëm me vlerën sipas gjendjes në kontabilitet. Me tej procedohet “Për krijimin e komisionit të asgjësimit të vlerave materiale”, i përbërë nga 5 veta i cili bën agjësimin e vlerave të propozuara për të dalë jashtë përdorimit. Në përfundim të inventarit vlera e llogarisë 327 (Inventar i imët) pasqyrohet në librat e llogarive bilancin e vitit për vlerën e mbetur (*Trajtuar më hollësisht në faqe 72-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 28 : DRISHMP Vlorë dhe strukturat përkatëse të marrë masa për kryerjen e inventarëve të vitit 2016, i cili ezauron edhe problemet e mbartura nga periudha e mëparshme, të krijojë komisionet përkatëse të inventarizimit, vlersimit dhe asgjësimit. Sektori i financë kontabilitetit të pasqyrojë veprimet në llogari dhe të paraqesë në mbylljen e bilancit të vitit 2016 diferencat e konstatuara, vlerën e materialeve të dala jashtë përdorimit dhe të asgjësuara, si dhe vlerën e materialeve të rikuperuara nëqoftëse ka.

Menjëherë

Gjetje 29 : Drejtoria e ISHMP Vlorë nuk ka kryer marrjen në dorzim të materialeve që vijnë nga mbyllja e veprimtarisë së DSHP Vlorë, në zbatim udhëzimeve të Ministria Mjedisit e cila ka bërë dyllosjen e zyrave të DSHP me urdhër të Ministrit nr. 10, datë 20.01.2016 “Mbi mënyrën e dyllosjes së zyrave të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Pyjor dhe Seksioneve Pyjore në të gjithë vendin. Në vazhdim të procesit me Urdhër të Ministrit nr. 30, datë 19.02.2016 është kërkuar kalimi në përgjegjësi administrimi dhe kalimi me inventar i godinave të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Pyjor, Inspektoriatit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve dhe Urdhërin nr. 85, datë 18.04.2016 për vazhdimin e procesit të ndarjes së zyrave dhe aseteve të tjera të ish Drejtorive të Shërbimit Pyjor në rrethe.

Për zbatimin e urdhërave të sipërpërmendur është bërë nga DSHP Vlorë vetëm një procesverbal jo i saktë, i mbajtur me përfaqësuesin e ISHMP Gj M me datë 16.05.2016, në zbatim të shkresës nr. 85, datë 18.04.2016, “Për vazhdimin e procesit të ndarjes së zyrave dhe aseteve të tjera të ish Drejtorive të Pyjore në rrethe. Në këtë procesverbal nuk janë pasqyruar kërkesat e dispozitave ligjore për plotësimin e formatit të regjistrimit të aktiveve i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afat shkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit. Kërkesat minimale që duhet të përmbajë rregjistri i aktiveve në vartësi të llojit, përfshijnë: datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Deri në periudhën e auditimit ISHMP nuk ka kryer këtë detyrë, me argumentin se bazuar në pikën

9 dhe 10 të shkresës nr. 85 datë 18.04.2016 është në pritje të një urdhëri të dytë të Ministrisë së mjedisit për ndarjen e aseteve (*Trajtuar më hollësisht në faqe 72-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 29: DRISHMP Vlorë dhe strukturat përkatëse të marrë masa për zbatimin e shkresës nr. 85, datë 18.04.2016, “Për vazhdimin e procesit të ndarjes së zyrave dhe aseteve të tjera të ish Drejtorive të Pyjore në rrethe. Për këtë të kërkojë nga Ministria e Mjedisit bashkëpunimin dhe urdhërimin e ish punonjësve të DSHP Vlorë për pjesëmarrjen në proces të dorzimit të aseteve ISHMP Vlorë duke hartuar procesverbalin përkatës dhe pasqyruar kërkesat e dispozitave ligjore për plotësimin e formatit ië regjistrin të aktiveve i cili hartohet në vartësi të llojit të tyre afatgjatë apo afat shkurtër si dhe grupit përkatës brenda llojit që duhet të përmbajë të dhënat sipas gjendjes në kontabilitet në datën e dyllyes dhe ndryshimet e mëvonëshme duke shënuar datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datën e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia.

Menjëherë

Gjetje 30: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, Sektori i Inspektiveve në Mjedis planin e inspektiveve nuk është i mbështetur në informacione të plota mbi numrin e subjekteve që operojnë në zonat të ndryshme dhe në total. Për rrjedhojë nuk ka të dhëna sa përqind e subjekteve janë mbuluar me inspektim. Mbi këtë bazë duhet të bëhet ndarja e subjekteve për çdo inspektor duke e përcaktuar dhe vlerësuar llojet e inspektimit në vartësi me kapacitetin ekonomik përcaktuar në ligjin 10431, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”. Mungesa e një klasifikimi të tillë bën të planifikimi të bëhet pa llogaritur risk duke përcaktuar subjektet me kapacitet ekonomik të madh, duke bërë një shpërndarje racionale të punës për çdo grup inspektorësh ose si individ për të siguruar një efektivitet të lartë inspektimi (*Trajtuar më hollësisht në faqe 54-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 30: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, Sektori i Inspektiveve në Mjedis të marrë masa që plani i inspektiveve ta mbështetet në informacione të plota mbi numrin e subjekteve që operojnë në zonat të ndryshme dhe në total. Për këtë të bashkëpunojë me Institucionet e qarkut si Drejtoria Rajonale e Tatimeve të Qarkut Vlorë, QKR, Bashki e Njësi Administrative dhe institucione të tjera që janë objekte të ndotjes dhe mbetjeve integrale. Mbi këtë bazë të bëjë ndarja e subjekteve për çdo inspektor duke e përcaktuar dhe vlerësuar llojet e inspektimit në vartësi me kapacitetin ekonomik përcaktuar në ligjin 10431, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”. Mungesa e një klasifikimi të tillë bën të planifikimi të bëhet pa llogaritur risk duke përcaktuar subjektet me kapacitet ekonomik të madh, duke bërë një shpërndarje racionale të punës për çdo grup inspektorësh ose si individ për të siguruar një efektivitet të lartë inspektimi.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Gjetje 31: DRISHMP Vlorë nuk ka planifikim të drejtë kohës optimale për kryerjen e një inspektimi. Në autorizimet e dhëna nuk përcaktohet verifikimi konkret **dokumentacionit** dhe bazës ligjore që mund të përbëje shkelje, si kushtet e lejes së mjedisit apo trajtimi i mbetjeve. Inspektimi spontan dhe pa llogaritur saktë kohën e kryerjes nuk jep konkluzione mbi ngarkesën dhe shfrytëzimin e kapaciteteve të burimeve njerëzore të institucionit (*Trajtuar më hollësisht në faqe 54-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 31. DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, sektori i mjedisit të marrë masa që në programet e inspektimit të përcaktohet në detaje inspektimi, duke u nisur nga informacioni paraprak dhe njohja profesionalisht e mundësisë së ndikimeve në mjedis, analiza e raportit teknik, duke parashikuar kohën e nevojshme për kryerjen e inspektimit.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Gjetje 32: Në DRISHMP Vlorë nga auditimi me zgjedhje i 30 praktikave ta inspektimeve të kryera konstatohet se në procesverbale nuk ka të dhëna mbi evidentimin e *shkeljes së kryer dhe reference* ligjore përkatëse. Gjithashtu edhe në vendimin e inspektorit nuk ka argumente për shkallën e ndëshkimit administrative, bazuar në dëmin e shkaktuar e të llogaritur në mjedis, zgjatjen e në kohë të efektit të dëmit, në se rasti shkeljes në së është përsëritur ose jo (*Trajtuar më hollësisht në faqe 54-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandimi 32. DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, sektori i inspektorëve të mjedisit të marrin masa dhe të pasqyrojnë hollësisht në procesverbalet e konstatimit dhe në formulimin e vendmeve, llojin e shkeljes dhe reference ligjore për të, dëmin ekonomik dhe arsye të tjera bindëse për masën ndëshkuese të kundravajtjes administrative.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Gjetje 33: DRISHMP Vlorë, Sektori i mjedisit ka kryer rreth 694 inspektime gjithsejtë prej të cilëve për vitin 2014-2015, për leje mjedisore janë kryer 438 inspektime dhe për masat e marra nga inspektorët si detyrë për aplikime për pajisjen me leje mjedisore janë konfirmuar nga QKL 208 raste gati 50 % e rasteve. Në këtë drejtim konstatohet pamjaftueshmëri në arritjen e përgjegjësisë së ndërsjellët dhe bashkëpunimit” dhe rezultatet e tij me institucione të tjera si Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Agjencia Kombëtare e Mjedisit. (*Trajtuar më hollësisht në faqe 54-61 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 33: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, Sektori i mjedisit të marrë masat e nevojshme të aftësoje inspektorët të bashkëpunojnë me QKL, të jenë në gjendje të hyjnë dhe marrin informacione në sistemin elektronik të saj e cila ka detyrim ligjor të përditësojë të dhënat e dërguara nga ARM dhe AKM. Marrja e një informacioni të tillë shërben për programin e riverifikimit të detyrave të lënë dhe rritjen e masave më shtrënguese për zbatimin e ligjit të ndikimeve në mjedis.

Menjëherë dhe vazhdimisht

Gjetje 34: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, sektori Juridik konstatohet se nuk ka zbatuar procedura ligjore të ekzekutimit dhe arkëtimit të gjobave të nga masat për dënimet administrative me vendosje gjobe për kundravajtjet në inspektimet e sektorit të mjedisit për periudhën e viteve 2014, 2015 dhe 6/mujori i parë i vitit 2016, konkretisht në 28 masa me vlerë 12,170 mijë lekë, për vitin 2014 për 4 gjoba me vlerë 4 590 mijë lekë, për vitin 2015, për 15 gjoba me vlerë 7,670 mijë lekë dhe 6 mujorin e parë të vitit 2016 për 9 gjoba me vlerë 3,910 mijë lekë, për një nivel të ulët të vjeljes së gjobave, mungesë të evidencimit, kontabilizimit dhe manexhimit financiar dhe kontrollit të ecurisë së procedurave ligjore të procesit administrativo ligjor, vonesat në kohë shprehur nga treguesit e lartpërmendur (*Trajtuar më hollësisht në faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 34: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, Sektori Inspektimit të Mjedisit, Juristi të marrin masa të hartojnë program të posaçëm *për zbatimin e procedurave ligjore te ekzekutimit dhe arkëtimit të gjobave të vendosura* për periudhën sektorit të mjedisit për periudhën e viteve 2014, 2015 dhe 6/mujori i parë i vitit 2016, konkretisht në 28 masa me vlerë 12,170 mijë lekë, për vitin 2014 për 4 gjoba me vlerë 4 590 mijë lekë, për vitin 2015, për 15 gjoba me vlerë 7,670 mijë lekë dhe 6 mujorin e parë të vitit 2016 për 9 gjoba me vlerë 3,910 mijë lekë, për një nivel të ulët të vjeljes së gjobave, mungesë të evidencimit, kontabilizimit dhe manexhimit financiar dhe kontrollit të ecurisë së procedurave ligjore të procesit administrativo ligjor (*Trajtuar më hollësisht në faqe 52-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Menjëherë dhe vazhdimisht

Gjetje 35: Në DRISHMP Vlorë grupet e inspektimit në terren kanë mbajtur proces-verbalet e inspektimit, të cilat nuk përmbajnë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe nuk janë shoqëruar me listë-verifikimin e plotësuar gjatë inspektimit, në moszbatim të nenit 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqe 61-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 35: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa dhe të instruktojë e të trajnojë inspektorët e terrenit për t’u njohur hollësisht me legjislacionin e mjedisit dhe të pyjeve si dhe mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera dhe krijuar po të jetë e nevojshme edhe dosje inspektimi duke mbajtur proces-verbalet e inspektimit, të cilat të përmbajnë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe të shoqërohen me listë-verifikimet e plotësuara gjatë inspektimeve, në zbatim të nenit 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdimisht

Gjetje 36: Në DRISHMP Vlorë, grupet e inspektimit në terren nuk kanë marrë mostra të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve, pajisjeve proceseve apo makinerive dhe t’ia nënshtronin ato ekzaminimit apo analizave, në sasinë e nevojshme për kryerjen e ekzaminimit apo analizave dhe për të siguruar përsëritjen e tij, nëse është e nevojshme, të kryera këto nga subjektet e akredituara, sipas legjislacionit në fuqi, në moszbatim të nenit 38, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 36: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa dhe të instruktojë e të trajnojë inspektorët e terrenit për t’u njohur hollësisht me legjislacionin e mjedisit dhe të pyjeve si dhe mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera dhe krijuar po të jetë e nevojshme edhe dosje inspektimi duke plotësuar praktikatat me materiale argumentuese si: mostra të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve, pajisjeve proceseve apo makinerive dhe t’ia nënshtronjë ato ekzaminimit apo analizave, në sasinë e nevojshme për kryerjen e ekzaminimit apo analizave dhe për të siguruar përsëritjen e tij, nëse është e nevojshme, të kryera këto nga subjektet e akredituara, sipas legjislacionit në fuqi, sipas nenit 38, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdimisht

Gjetje 37 : Në DRISHMP Vlorë, grupet e inspektimit në terren nuk kanë kërkuar dhe as kanë marrë kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektimit dhe nuk ka asnjë rast sekuestrimi të dokumenteve që lidhen me objektin e inspektimit, si dhe dokumente të ruajtura në trajtë elektronike, regjistrime elektronike e audio-vizive apo të çdo lloj teknologjie tjetër me qëllim verifikimin e autenticitetit apo korrektësisë së informacionit, në moszbatim të nenit 39, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 37 : DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa dhe të instruktojë e të trajnojë inspektorët e terrenit për t’u njohur hollësisht me legjislacionin e mjedisit dhe të pyjeve si dhe mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera dhe krijuar po të jetë e nevojshme edhe dosje inspektimi duke plotësuar praktikatat me materiale argumentuese si: kopje të dokumenteve të veprimtarisë, në përputhje me objektin e inspektimit, sekuestrime të dokumenteve që lidhen me objektin e inspektimit, si dhe dokumente të ruajtura në trajtë elektronike, regjistrime elektronike e audio-vizive apo të çdo lloj teknologjie tjetër me qëllim verifikimin e autenticitetit apo

korrektësisë së informacionit, në zbatim të nenit 39, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdimisht

Gjetje 38: Në DRISHMP Vlorë, grupet inspektimit në terren nuk kanë kryer fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjediseve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit, në moszbatim të germës “a”, neni 41, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 38 : DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa dhe të instruktojë e të trajnojë inspektorët e terrenit për t'u njohur hollësisht me legjislacionin e mjedisit dhe të pyjeve si dhe mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera dhe krijuar po të jetë e nevojshme edhe dosje inspektimi duke plotësuar praktikën me materiale argumentuese si: fotografime, filmime apo regjistrime me mënyra a mjete të tjera teknike të mjediseve, instalimeve, proceseve të punës dhe godinave, mjediseve, objekteve, mjeteve të transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendeve, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër, që lidhet me veprimtarinë e subjektit të inspektimit, në zbatim të germës “a”, neni 41, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdimisht

Gjetje 39 : Në DRISHMP Vlorë, grupet e inspektimit në terren nuk kanë inspektuar çdo dokument apo regjistrim të nevojshëm për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, përfshirë edhe ato të ruajtura, të krijuara apo të mbajtura në format elektronik, apo çdo teknikë tjetër, nuk kanë bërë matjet e nevojshme për të verifikuar respektimin e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit, nuk kanë kryer verifikime të dokumenteve për identitetin e personave, kur kjo është e nevojshme, sipas objektit të inspektimit dhe nuk është administruar çdo mjet tjetër prove, sipas Kodit të Procedurave Administrative, për përcaktimin e situatës faktike dhe rrethanave të nevojshme për marrjen e një vendimi përfundimtar, në moszbatim të germave “b”, “c”, “ç”, “e”, të nenit 41, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 39: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa dhe të instruktojë e të trajnojë inspektorët e terrenit për t'u njohur hollësisht me legjislacionin e mjedisit dhe të pyjeve si dhe mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera dhe krijuar po të jetë e nevojshme edhe dosje inspektimi duke plotësuar praktikën me materiale argumentuese si: dokumente apo regjistrime të nevojshme për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, përfshirë edhe ato të ruajtura, të krijuara apo të mbajtura në format elektronik, apo çdo teknikë tjetër, matjet e nevojshme për të verifikuar respektimin e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit, verifikime të dokumenteve për identitetin e personave, kur kjo është e nevojshme, sipas objektit të inspektimit çdo mjet tjetër prove, sipas Kodit të Procedurave Administrative, për përcaktimin e situatës faktike dhe rrethanave të nevojshme për marrjen e një vendimi përfundimtar, në zbatim të germave “b”, “c”, “ç”, “e”, të nenit 41, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdimisht

Gjetje 40: Në DRISHMP Vlorë, grupet e inspektimit në terren kanë mbajtur proces-verbalet e inspektimit, të cilat nuk përmbajnë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe nuk janë shoqëruar me listë-verifikimin e plotësuar gjatë inspektimit, në moszbatim të nenit 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për

Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”(Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 40: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa dhe të instruktojë e të trajnojë inspektorët e terrenit për t'u njohur hollësisht me legjislacionin e mjedisit dhe të pyjeve si dhe mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera dhe krijuar po të jetë e nevojshme edhe dosje inspektimi duke mbajtur proces-verbale të inspektimit, të cilat të përmbajnë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe të shoqërohen me listë-verifikimet e plotësuara gjatë inspektimeve, në zbatim të nenit 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

Vazhdimisht

Spektori i Mjedisit (6-Mujori I viti 2016)

Gjetje 41 : Në DRISHMP Vlorë, në **16 raste**, grupet e inspektimit në terren nuk kishin mbajtur proces-verbale inspektimi dhe nuk kishin nënshkruar në relacion, në mospajtim me pikën 1, neni 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” sipas Tabelës nr. 1: “Inspektime në Mjedis pa mbajtur procesverbale Inspektimi” (Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 41: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa dhe të instruktojë e të trajnojë inspektorët e terrenit për t'u njohur hollësisht me legjislacionin e mjedisit dhe të pyjeve si dhe mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera dhe duke mbajtur proces-verbale të inspektimit, të cilat të përmbajnë informacion të hollësishëm për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet procedurale të marra gjatë inspektimit dhe të shoqërohen me listë-verifikimet e plotësuara gjatë inspektimeve, në zbatim me pikën 1, të nenit 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdimisht

Gjetje 42: Në DRISHMP Vlorë, në **6 raste**, grupet e inspektimit në terren nuk kishin lënë afat për zbatimin e detyrave, në moszbatim të nenit 65, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, gjë që le shteg për mos ndjekje të detyrave të lëna dhe në përfundim mos evidentim të rasteve për vendosje gjobash dhe pezullim të aktivitetit (Trajtuar më hollësisht në Tabelën nr.2: “Mbi afatet e zbatimit të detyrave në inspektimet në Mjedis 6/Mujori I-rë 2016”, bashkëlidhur (Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 42: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa dhe të instruktojë e të trajnojë inspektorët e terrenit për t'u njohur hollësisht me legjislacionin e mjedisit dhe të pyjeve si dhe mënyrën e aplikimit të këtij legjislacioni gjatë inspektimeve të kryera dhe për konstatimet e kryera në inspektimin e parë të ushtruar në subjektet e inspektimit, të lihen detyra për zbatim me afate të përcaktuara duke mos kaluar tavanin e vendosur ligjërisht prej 8 ditësh, në zbatim të pikës 4, neni 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe neni 65, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.

Vazhdimisht

Gjetje 43: Në DRISHMP Vlorë, në **36 raste** (të gjithë rastet e audituara), grupet e inspektimit në terren nuk kishin zbatuar objektivat e inspektimit, lidhur me: kontrollin e dokumentacionit tekniko-ligjor për ushtrimin e aktivitetit, të dhënat e vet monitorimit për shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë, planin e menaxhimit të mbetjeve, raportimin e të dhënave të vet monitorimeve në institucionet përgjegjëse ARM, AKM dhe ISHMP Vlorë”, duke kryer vetëm një verifikim të thjeshtë për lëshimin e lejes mjedisore dhe pagesat vjetore lidhur me to, dhe në këto raste *proces-verbale të mbeten formale, gjë që i bën misionet e inspektimit: jo eficiente, jofunksionale, të paplota, në moszbatim të: neni 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2016 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, neni 65, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për lejet e mjedisit”, neni 14 “Vlerat*

kufi të shkarkimeve”, sipas shtojcës “2”, bashkëlidhur ligjit, “Lista indikative e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh në q s kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve” të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, me nenin 19 “Vetë monitorimi”, me ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” pasqyruar në Tabelën nr. 6: “Mbi verifikimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për ushtrimin e aktivitetit, të dhënat e monitorimit në ajër, tokë dhe ujë,6/Mujori I-rë 2016”, (Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 43: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa dhe të hartojë objektiva të qarta, të zbatueshme, në përputhje me planifikimin vjetor të institucionit, duke u bazuar në risqet e veprimtarisë së subjekteve; të vendosë afate inspektimi konform objektivave të inspektimit dhe për 126 rastet e konstatuara (të gjithë rastet) dhe në të ardhmen në vazhdim, të ushtrohen inspektime lidhur me: kontrollin e dokumentacionit tekniko-ligjor për ushtrimin e aktivitetit, të dhënat e vet monitorimit për shkarkimet në ajër, tokë dhe ujë, planin e menaxhimit të mbetjeve, raportimin e të dhënave të vet monitorimeve në institucionet përgjegjëse ARM, AKM dhe ISHMP Vlorë, sipas nenit 45, të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2016 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; nenit 65, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për lejet e mjedisit”; nenit 19 “Vetë monitorimi” dhe nenit 14 “Vlerat kufi të shkarkimeve”, të ligjit nr. 10448, datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, sipas shtojcës “2”, bashkëlidhur ligjit, “Lista indikative e substancave kryesore ndotëse që duhen marrë parasysh në q s kanë rëndësi për caktimin e vlerave kufi të shkarkimeve”; me nenin 19, të ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve” pasqyruar në Tabelën nr. 6: “Mbi verifikimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për ushtrimin e aktivitetit, të dhënat e monitorimit në ajër, tokë dhe ujë,6/Mujori I-rë 2016”,

Deri 31.03.2017 dhe Vazhdimisht

Gjetje 44: Në DRISHMP Vlorë, në **110 raste**, konstatohet se deri më datë 30.06.2016, nuk kishte ushtruar inspektim për verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna, në moszbatim të nenit 65, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” dhe në **1 rast**, në Bashkinë Ksamil, inspektorët nuk kishin lënë detyrë, në moszbatim të nenit 65, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (Trajtuar më hollësisht në Tabelën nr. 3: “Mbi verifikimin e detyrave të lëna nga Inspektimet në Mjedis 6/Mujori I-rë 2016”, bashkëlidhur (Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 44: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa në vazhdimësi dhe të kryejë inspektimet e dyta në subjektet e inspektimit, menjëherë pas përfundimit të afatit 8 ditor për zbatimin e detyrave të lëna nga grupet e inspektimit në terren, duke kryer verifikimin e zbatimit të detyrave. Për 111 rastet e konstatuara të kryhet verifikimi i zbatimit të rekomandimeve dhe në rast moszbatimi të aplikohet vendosja e gjobës, sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe dispozitave të ligjeve përkatëse të fushës së mjedisit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

Sektori i Ujërave (6-Mujori II viti 2014-Mars 2015)

Gjetje 45: Në DRISHMP Vlorë, nga auditimi konstatohet se dosjet me praktikatat e inspektimit të Sektorit të Ujërave, shkresat, korrespondencat dhe dokumentacioni tjetër, nuk ishin transferuar në NJQV Bashkia Vlorë, njësi vendore në varësi të së cilës ka kaluar Sektori i Ujërave, bazuar në urdhrin nr. 1132/1, datë 23.02.2015 (Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 45: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa dhe të përcjellë zyrtarisht në Dega Rajonale ISHU Qarku Vlorë, dosjet me praktikatat e inspektimit të Sektorit të Ujërave, shkresat, korrespondencat dhe dokumentacionin tjetër relevant, për këtë fushë të inspektimit.

Menjëherë

Dega Rajonale ISHU Qarku Vlorë në varësi të ISHU Tiranë strukturë e Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në bashkëpunim me DRISHMP Vlorë,

Gjetje 46: Në DRISHMP Vlorë, për **50 raste**, konstatohet se grupet e inspektimit në terren nuk kishin lënë afate për detyrat nga grupet e inspektimit në terren, në moszbatim të nenit 65, të ligjit nr, 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit (Trajtuar më hollësisht në Tabelën nr. 5: “Mbi lënien dhe verifikimin e detyrave të lëna nga Inspektimet në menaxhimin e ujërave të ndotura 2016” bashkëlidhur (Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 46: **Dega Rajonale ISHU Qarku Vlorë** dhe DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa në vazhdimësi dhe të kryejë inspektimet e dyta në subjektet e inspektimit, menjëherë pas përfundimit të afatit 8 ditor për zbatimin e detyrave të lëna nga grupet e inspektimit në terren, duke kryer verifikimin e zbatimit të detyrave. Për 50 rastet e konstatuara të kryhet verifikimi i zbatimit të rekomandimeve dhe në rast moszbatimi të aplikohet vendosja e gjobës, sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe dispozitave të ligjeve përkatëse të fushës së mjedisit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

Gjetje 47: Në DRISHMP Vlorë në **38 raste**, konstatohet se Dega Rajonale e ISHMP-së, Qarku Vlorë, deri më datë 30.06.2016, nuk kishte ushtruar inspektim për verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna, në moszbatim të nenit 65, të ligjit nr, 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (Trajtuar më hollësisht në Tabelën nr. 7 “Mbi verifikimin e zbatimit të detyrave të lëna nga sektori i ujërave” bashkëlidhur (Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 47: **Dega Rajonale ISHU Qarku Vlorë** dhe DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa në vazhdimësi dhe të kryejë inspektimet e dyta në subjektet e inspektimit, menjëherë pas përfundimit të afatit 8 ditor për zbatimin e detyrave të lëna nga grupet e inspektimit në terren, duke kryer verifikimin e zbatimit të detyrave. Për 38 rastet e konstatuara të kryhet verifikimi i zbatimit të rekomandimeve dhe në rast moszbatimi të aplikohet vendosja e gjobës, sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe dispozitave të ligjeve përkatëse të fushës së mjedisit.

Menjëherë dhe Vazhdimisht

Gjetje 48: Në DRISHMP Vlorë, për **3 raste**, konstatohet se grupet e inspektimit në terren kishin lënë detyra sipas standardit “I lihet detyrë të rehabilitojë mjedisin sipas kushteve të përcaktuara në lejen mjedisore”, detyra të cilat janë të përgjithshme, të papërcaktuara, të pa plota, pasi nuk janë përcaktuar shkeljet përkatëse të cilat janë konstatuar në lejet mjedisore dhe të cilat nuk janë respektuar, në moszbatim të nenit 65, të ligjit nr, 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” (Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 48: **Dega Rajonale ISHU Qarku Vlorë** dhe DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa dhe të programojë inspektime në të 3 subjektet e inspektimit, duke përcaktuar qartë cilat janë shkeljet e subjektit, sipas lejes mjedisore, duke lënë detyrat përkatëse brenda afatit ligjor prej 8 ditësh, duke kryer verifikimin e tyre menjëherë pas përfundimit të afatit ligjor dhe varësisht duke proceduar me vendosje gjobe (nëse nuk zbatohen detyrat).

Deri më datë 31.01.2017

Gjetje 49: Në DRISHMP Vlorë, në **1 rast**, për subjektin e inspektimit “A“ shpk; Aktiviteti: “Pikë tregtimi karburanti” konstatohet se: “Subjekti nuk është i pajisur me një instalim depozitë për përdorimin e ujit. Subjekti nuk ka një impiant funksional të trajtimit të ujërave të bardha-zeza”. Nuk disponon një kanal separator për hidrokarburet” dhe grupi i inspektimit në terren nuk kishte lënë detyra në moszbatim të nenit 65, të ligjit nr, 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”

(Trajtuar më hollësisht në faqet 59-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

Rekomandim 49: Dega Rajonale ISHU Qarku Vlorë dhe DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, të marrë masa në vazhdimësi dhe të vendosë detyrat për subjektin e inspektimit “A”, kryejë inspektimin e dytë në subjektin e inspektimit, menjëherë pas përfundimit të afatit 8 ditor dhe në rast moszbatimi të aplikohet vendosja e gjobës, sipas ligjit nr. 10 279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe dispozitave të ligjeve përkatëse të fushës së mjedisit.

Deri më datë 31.01.2017

Gjetje 50-: Në DRISHMP Vlorë, njësia e prokurimit, në procesin e tenderimeve për blerjet e vogla ka kërkuar në mënyrë të panevojshme në katër procedurat e audituara marrjen e mostrave. Ky veprim nuk është në referencë të ligjit për “Blerjet e vogla”*(Trajtuar më hollësisht në faqe 81-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandimi 50: Në DRISHMP Vlorë, njësia e prokurimit të marrë masa për trajnimin e punonjësve me ligjin e prokurimit publik dhe VKM përkatëse. Veçanërisht njihjen me hartimin e dokumenteve të tenderit dhe kërkesat e veçanta për kualifikim.

Në vazhdimësi

Gjetje 51: Nga auditimi i praktikave për blerjet e vogla konstatohen se fituesi i ofertës në tre raste nuk ka zbatuar afatet e kontratës për lëvizimin e mallrave. DRISHMP ka bërë hyrje të mallrave me afate deri në një muaj vonesë, veprim në kundërshtim me LPP dhe VKM, ku përcaktohet se mosplotësimi i kontratës Brenda afatit kohor anulon ofertuesin e parë dhe ndiqet radha sipas klasifikimit të ofertave deri në fituesin e pestë”*(Trajtuar më hollësisht në faqe 81-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandimi 51: DRISHMP Vlorë, njësia e prokurimit të marrë masa për zbatimin me korrektësi të dispozitave të ligjit dhe VKM duke respektuar klasifikimin e ofertave dhe limitet kohore që dorëzimit të mallrave në rastet kur fituesi nuk paraqitet në afat.

Në vazhdimësi

Gjetje 52: DRISHMP Vlorë, konstatohet se nuk ka arkivuar praktikave të tenderëve të përfunduar, veprim ky në kundërshtim me udhëzimin Nr.05, datë 27.01.2015 ku citohet se “*nëpunësi i autorizuar klikon dy herë në hapin “Arkivimi i kontratës” në dritaren e hapur dhe vendos arsytet për të arkivuar procedurën. Pas këtyre veprimeve procedura duhet të kalojë te skedari “Arkiva” dhe ligjin nr 9154 për arkivat,*”*(Trajtuar më hollësisht në faqe 81-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandimi 52 : DRISHMP Vlorë, njësia e prokurimit të marrë masat e nevojshme për arkivimin në sistemin elektronik dhe arkivin shkresore të institucionit të praktikave të tenderave të përfunduar.

Menjëherë

Gjetje 53: Konstatohet se njësia e prokurimit nuk është e aftësuar për manipulimin e sistemit elektronik në rastin e tërheqës së operatorëve fitues. Kjo bie në kundërshtim me udhëzimin Nr.05, datë 27.01.2015 “*Për zhvillimin e procedurave të prokurimit me vlerë të vogël në sistemin e prokurimit Elektronik*” ku tek **Njoftimi i fituesit** citohet: “*Nëpunësi i autorizuar i KPVV klikon dy herë në hapin “Njoftimi i fituesit”. Në dritaren e hapur sistemi mundëson raportin e vlerësimit final. Në dritaren që shfaqet njoftimi i fituesit së bashku me emrin e operatorit ekonomik të shpallur fitues është krijuar automatikisht nga sistemi” dhe me kriterin e vendosur në ftesën për ofertë “OE që do të kualifikohet si fitues, brenda 24 orëve nga marrja e njoftimit të klasifikimit, duhet të paraqitet pranë AK-së, përndryshe fitues do të shpallet OE vijues në klasifikimin përfundimtar”* *(Trajtuar më hollësisht në faqe 81-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

Rekomandim 53: DRISHMP Vlorë, njësia e prokurimit të kryej trajnimet e nevojshme dhe bashkëpunojë me institucione të bashkisë apo qarkut Vlorë të cilat kanë personel të aftësuar në këtë fushë.

Në vazhdimësi

Gjetje 54: DRISHMP Vlorë, në cilësinë e autoritetit kontraktor për prokurimet publike në asnjë rast nuk ka nxjerrë urdhër me të cilin ngarkohet Njësia e Prokurimit për përgatitjen e kërkesave për përgatitjen e Regjistrimit të Parashikimeve dhe realizimit të Prokurimeve, si dhe hedhjen e tij në sistemin elektronik. Kjo bie ndesh me *Ligjin 914 datë 29.12.2014 dhe ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, për "Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin"*, Neni 15, 22. Gjithashtu është konstatuar se në asnjë rast nuk ka Urdhër të titullarit për ngritjen e grupit të punës për të bërë testimin e tregut. Në asnjë dosje prokurimi me vlerë të vogël nuk gjenden oferta të ngjashme apo tregues të tjerë që të ndihmojnë për përcaktimin e fondit limit. Kjo bie në kundërshtim me Urdhër të Ministrit të Financave nr 33 date 11-07-2013 "(Trajtuar më hollësisht në faqe 81-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 54: DRISHMP Vlorë në cilësinë e autoritetit kontraktor të marrë masat e nevojshme që në procesin e tenderimit me "Blerje të vogla" të nxjerrë urdhrat përkatës për përgatitjen e Regjistrimit të Parashikimeve dhe përcaktimin e fondit limit sipas mënyrave të përcaktuara në VKM dhe veçanërisht në rastet kur është nevoja e testimit të tregut.

Në vazhdimësi

Gjetje 55: Në DRISHMP Vlorë, njësia e prokurimit në të gjitha dosjet e audituara konstatohet se mungon raporti i vlerësimit final. Kjo bie në kundërshtim me Urdhër të Ministrit të Financave nr 33 dt. 11-07-2013 "Gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë", ku për "blerjet e vogla" përcaktohet : "**Procesi**" Raporti i Vlerësimit Final , me "**Referenca ligjore**" VKM nr.914, datë 29.12.2014 "Për Rregullat e Prokurimit Publik" (Trajtuar më hollësisht në faqe 81-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 55: DRISHMP Vlorë në cilësinë e autoritetit kontraktor të marrë masat e nevojshme që anëtarët e KPVV të procedojnë me raportin e vlerësimit final, i cili gjenerohet nga sistemi elektronik i prokurimeve.

Menjëherë

Gjetje 56: Në DRISHMP Vlorë, në periudhën 2014-2015 ka propozuar dhe paraqitur në inspektoratin qendror marrjen në punë të tre punonjësve të cilët janë anuluar me shkresën me nr prot: 3301 datë 30.10.2014 me lëndën "Verifikimi I statusit të nëpunësve dhe punonjësve aktualë", nga DAP, pasi nuk kanë pasur arsimimin e duhur për të përfutur statusin. Për këtë me shkresat nr. 17,18 dhe 27, datë 10.02.2015, janë ndërprerë dhe nuk janë rinovuar kontratat individuale të punës për 3 punonjës z. A. H me detyrë Inspektor në sektorin e Inspektimit Mjedisor, z. A. D me detyrë Inspektor në sektorin e Inspektimit të Ujërave dhe z.A. S, me detyrë Inspektor në sektorin Mjedisor (Trajtuar më hollësisht në faqe 72-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandim 56: DRISHMP Vlorë, të marrë masa me qëllim që në të ardhmen të mos rekrutojë punonjës të rinj pa zbatuar kriteret e konkurrimit sipas ligjit mbi emërimet në punë.

Në vazhdimësi

C.1. TË ARDHURA TË MUNGUARA

Gjetje 1: Në 39 raste, grupet e inspektimit në terren, kishin kryer inspektime me objekt "Menaxhimi i ujërave të ndotura", dhe kishin evidentuar se: "Shkarkimi i ujërave të zeza, prej subjekteve fizike dhe juridike bëhet në "**gropa septike**, në "**depozita**" ose "**sisteme**" të tjera, që më pas tërhiqen me Auto-bote dhe depozitohen në vend-grumbullimin e caktuar", raste të cilat i kanë konsideruar të rregullta, gjë që nuk jep garanci për ruajtjen e mjedisit, pa u bazuar në dokumentacionin përkatës tekniko-ligjor dhe pa bërë një argumentim të përshtatshëm dhe të justifikuar, për pranimin e ndërtimit të "gropës septike", si sistem i sigurt për ruajtjen e mjedisit dhe

pa shpjeguar edhe rrethanat të cilat nuk lejojnë ndërtimin e rrjetit të kanalizimit, në një kohë që në asnjë rast nuk pranohet si zgjidhje ligjore për shkarkimin e ujerave të zeza “gropa septike”,

Këto janë veprime dhe mosveprime, në moszbatim të germës “c”, të nenit 11, të ligjit nr. 9115, datë 24.07.2003 “Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura”, dhe pikës “1”, të nenit 74, të ligjit nr. 111, datë 15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, ku citohet: *“Për të gjitha veprimtaritë që gjenerojnë ujëra të ndotura është e detyrueshme të lidhen dhe të përdoren kanalizimet e ujërave të ndotura, në përputhje me legjislacionin që rregullon shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, si dhe me aktet nënligjore që zbatohen në këtë fushë”.*

Sa më sipër, inspektorët duhej të kishin analizuar hollësisht dhe të kishin provuar që ndërtimi dhe rehabilitimi i gropës septike të garantojë mbrojtjen e mjedisit gjë që nuk është bërë, duke mos mbajtur “proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjeve administrative”, duke mos vendosur gjobë në masën nga 500,000 lekë deri në 1,000,000 lekë, sipas pikës 16, të nenit 97 të ligjit nr. 111, datë 15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, si dhe të kishin ndërmarrë veprime për pezullimin e aktivitetit.

Këto veprime dhe mosveprime janë në mospajtim me nenin 6 dhe pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenin 66, të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.

Sa më sipër për **39 rastet (praktikat)**, si rezultat i mos vendosjes së gjobave, **konstatohet një e ardhure e munguar nga 19,500,000 lekë deri në 39,000,000 lekë**, për faktin e paligjshmërisë së gropave septike dhe të çdo sistemi tjetër të pasigurt, në funksion të ruajtjes së mjedisit nga ujërat e ndotura, paraqitur në tabelën emërtuar “Mosaplikimi i Gjobave në Inspektimet Mbi Menaxhimin e Ujërave të Ndotura Tabela nr.4” (*Trajtuar më hollësisht në faqet 63-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 1: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, strukturat përkatëse, Sektori Mjedisit Juristi dhe Njësia e Financës të marrë masa konformë dispozitave ligjore në fuqi për riinspektimin dhe mbajtjen parasysh të mosvendosjes së gjobave për **39 subjektet-praktikat**, me pasojën të ardhurave të munguara **39,000,000 lekë** (niveli maksimal i gjobës), dhe në inspektimet e radhës të procedojë me mbajtjen e proces-verbaleve për konstatimin e kundërvajtjeve administrative dhe marrjen e vendimeve administrative për vendosjen e gjobave, për shumat e sipërpërmendura dhe të lajmërojë subjektet debitore pasi t'i regjistrojë detyrimet në kontabilitetin e institucionit dhe më pas të kryejë arkëtimin e gjobave prej subjekteve, duke ndjekur të gjithë hapat e nevojshëm administrativo-ligjorë dhe në të gjithë shkallët e sistemit gjyqësor, deri në shterimin e plotë të gjithë mundësive, sipas emërtuar “Mosaplikimi i Gjobave në Inspektimet Mbi Menaxhimin e Ujërave të Ndotura Tabela nr.4”.

Deri më datë 31.03.2017

C.2 MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë”, pjesa e VI, Kreu I, nenet 105-109 dhe udhëzimin e Ministrisë së Financave, nr 30, datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve, pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësit Autorizues), të nxirren aktet administrative dhe (Nëpunësi zbatues), të kryejë kontabilizimet duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore, administrative dhe procedurat përmbartimore me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, në vlerën totale **2,500,000 lekë**, si më poshtë:

Gjetje 1: Nga sektori i inspektimit të mjedisit sipas autorizim inspektimit nr. 162 prot, datë 10.07.2014, firmosur nga Kryeinspektori Gj .M, inspektor I .M dhe A .Q janë dërguar për inspektim me objekt menaxhimi i integruar i mbetjeve në subjektin Lukove Komunë, të qarkut Vlorë, “me përfaqësues administratorin V. K.

Nga inspektorët është mbajtur procesverbali i mbajtur me nr. serie 0005981, datë 10.07.2014 mbi inspektimin e kryer është konstatuar se në objektin e lartpërmendur kanë rënë zjarre, dhe nuk ka leje mjedisore. Inspektori ka lënë për detyrë eliminimin e zjarreve dhe largimin e mbetjeve brenda 10 ditëve. Sipas procesverbalit të konstatimit të lartpërmendur subjekti nuk ka kryer largimin e mbetjeve në përputhje me ligjin. Bazuar në aktin administrativ nr 1, datë 23.07.2014 me nr. serie 0000016 në mbështetje të nenit 48 të ligjit 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në zbatim të pikës 24 të nenit 3 të ligjit 10431, datë 22.09.2012 “Për menaxhimin të intergruar të mbetjeve” Komuna Lukove gjobitet me 500.000 lekë gjobë. Subjekti ka bërë ankimim në Inspektoriatin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve i cili, me shkresë nr. 939, prot datë 24.03.2015 përcjellë vendimin e komisionit të ankimit vetëm me firmë të Kryeinspektorit E A duke shfuqizuar vendosjen e gjobës. Në vendim nuk ka asnjë argument të shfuqizimit të vendimit nr. 1, datë 23.07.2014, dhe nga ISHMP nuk është bërë rekurs në gjykatë.

-Në dosje nuk ka referencë apo kopje të ankimit si dhe Komisionit i Ankimit në vendimin e tij nuk ka cilësuar në se ka apo jo një ankesë nga subjekti (*Trajtuar më hollësisht në faqet 49-50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Rekomandim 1: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, strukturat përkatëse, sektori i inspektimit, Juristi dhe Njësia e Financës të marrin masa të kontabilizojnë dhe të kërkojnë arkëtimin e gjobës prej **500,000 lekë** nga Komuna Lukovë duke ndjekur të gjithë rrugët ligjore pasi Vendimi i Komisionit të Ankimit është i pa dokumentuar dhe bazuar në ligj, pasi ka kaluar afati ligjor i shqyrtimit të ankimit.

Deri më datë 31.03.2017

Gjetje 2: Nga auditimi rezulton se grupet e inspektimit në terren kishin konstatuar shkelje në veprimtarinë e kryer nga subjekti i inspektimit: “G B” me aktivitet “Marrje e Inerteve nga lumi”, ku pas 2 inspektimeve vazhdon veprimtaria e kundërligjshme *ndërrhyrje intensive të shfrytëzimit të inerteve në shtratin e lumit “Vjosë”*, ku sipas grupit të inspektimit janë marrë edhe foto+video, dhe nuk është mbajtur proces-verbalit për konstatimin e kundërvajtjeve administrative, meqenëse kemi një veprim në kundërshtim me nenin 44, të ligjit nr. 111, datë 15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, lidhur me shfrytëzimin e materialeve inerte dhe një rast që përbën rrezik të mundshëm për ndotje serioze të mjedisit, dhe nuk është aplikuar **gjobë nga inspektorët, që varion nga 1,000,000 deri në 2,000,000 lekë**, sipas pikës 5, neni 97, të ligjit nr. 111, datë 15.12.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”.

Këto veprime dhe mosveprime janë në mospajtim me nenin 6 dhe pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe nenin 66 të ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”(trajtuar në faqet 65-66 të raportit përfundimtar të auditimit)

Rekomandim 2: DRISHMP Vlorë, Kryeinspektori, strukturat përkatëse, Sektori Mjedisit, Juristi dhe Njësia e Financës, të marrë masa konformë dispozitave ligjore në fuqi, për konstatimin e shkeljeve në veprimtarinë e kryer nga subjekti i inspektimit: “G B”, për konstatimin e të ardhurave të munguara **2,000,000 lekë** (niveli maksimal i gjobës), të procedojë me mbajtjen e proces-verbalit për konstatimin e kundërvajtjeve administrative dhe marrjen e vendimit administrativ për vendosjen e gjobës, për shumën e sipërpërmendur dhe të lajmërojë subjektin debitor pasi t'i regjistrojë detyrimet në kontabilitetin e institucionit dhe më pas të kryejë arkëtimin e gjobës prej subjektit, duke ndjekur të gjithë hapat e nevojshëm administrativo-ligjorë dhe në të gjithë shkallët e sistemit gjyqësor, deri në shterimin e plotë të gjithë mundësive.

Deri më datë 31.03.2017

C. MASA DISIPLINORE

C/1. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, **i rekomandoj Kryeinspektorit ISHMP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësive për çdo punonjës me status nëpunësi civil fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga “**Vërejtje**” deri në “**Mosngritje në detyrë për 2 vjet**” për:

1. **Për z. Gj. M**, me detyrë Kryeinspektor, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në **Procesverbali nr.1, datë 14.11.2016, Procesverbali nr. 2, datë 19.11.2016, Procesverbali nr. 3, datë 21.11.2016, Procesverbali nr. 4, datë 22.11.2016, Procesverbali nr. 5, datë 23.11.2016, procesverbalet nr. 7 dhe 8, datë 13.10.2016, Procesverbali nr. 9, datë 23.11.2016, Aktverifikimi nr. 1, datë 14.11.2016,**
2. **Për z. I. M**, me detyrë Përgjegjës Sektori Mjedisit prej Prill 2015, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në **Procesverbali nr.1, datë 14.11.2016, Procesverbali nr. 2, datë 19.11.2016** për vitin 2014 praktikant 2,7 dhe për vitin 2015 praktika 11, **procesverbali nr. 6, datë 23.11.2016, procesverbali nr. 8 datë 13.10.2016, Aktverifikimi nr. 1, datë 14.11.2016,**
3. **Për z. Ç. Z**, me detyrë Specialist Finance, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në **Procesverbali nr.1, datë 14.11.2016, Procesverbali nr. 3, datë 21.11.2016, Procesverbali nr. 4, datë 22.11.2016, Procesverbali nr.5, datë 23.11.2016, Procesverbali nr.9, datë 23.11.2016, Aktverifikimi nr. 1, datë 14.11.2016,**
4. **Për z. E. B**, me detyrë inspektor sektori Mjedisit për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në **procesverbali nr.6, datë 23.11.2016 procesverbal nr. 8 datë 13.10.2016**

C/2. Mbështetur në Kreu IV, germa “c” dhe “ç” dhe neni 37, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 8085, datë 13.03.1996 dhe ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003 si dhe në kontratën individuale të punës, në ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjit nr. 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” **ti kërkojmë Kryeinspektorit ISHMP Tiranë**, vlerësimin e shkallës së përgjegjësive për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore për ata me kontratë, nga masa “**Vërejtje**”, për këta punonjës:

1. **Për z. E. B** me detyrë Përgjegjës Sektori Pyjeve prej Prill 2015 për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në **Procesverbali nr.1, datë 14.11.201, Procesverbali nr. 2, datë 19.11.2016** për vitin 2014 praktikant 6,11,12, për vitin 2015 praktikant 3, 14, për 6/mujorin e I-rë vitin 2016 praktikant 14, 15, **Procesverbali nr. 4, datë 22.11.2016, Procesverbali nr. 5, datë 23.11.2016, procesverbal nr. 7, datë 13.10.2016, Aktverifikimi nr. 1, datë 14.11.2016,**
2. **Për z. E. K**, me detyrë inspektor, për vitin 2014 praktikant 1, 2, 4, 7,9, 10, 13, për vitin 2015 praktikant 1,2, 5, 6,7, 8, 10, 11,13, 19, 22, 24, për 6/mujorin e I-rë vitin 2016 praktikant 5, 8,13, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit **Procesverbali nr. 2, datë 19.11.2016, Procesverbali nr. 5, datë 23.11.2016, procesverbali nr. 8 datë 13.10.2016,**
3. **Për z. A. H**, me detyrë inspektor për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit për vitin 2014 praktikant 3,5, 8, për vitin 2015 praktikant 4, 12, 14,16, 20, për 6/mujorin e I-rë vitin 2016 praktikant 1,2, 4, 12,13, **Procesverbali nr. 2, datë 19.11.2016, Procesverbali nr.5, datë 23.11.2016,**

4. **Për z. N. Ç**, me detyrë inspektor për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit për vitin 2014 praktikat 4, 9 7,10, 13, për vitin 2015 praktikat 1, 2, 5, 6,7, 8, 10, 11, 13 19, 22, 24, për 6/mujorin e I-rë vitin 2016 praktikat 5, 8 **Procesverbali nr. 2, datë 19.11.2016, Procesverbali nr.5, datë 23.11.2016, procesverbali nr. 8 datë 13.10.2016,**

5. **Për z. L. P**, me detyrë inspektor për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit për vitin 2014 praktikat 6, 11,12, për vitin 2015 praktikat 3,9 ,12, 14,15, 16, 17, 18,21,23, për 6/mujorin e I-rë vitin 2016 praktikat 4, 6,9,11,16, **Procesverbali nr. 2, datë 19.11.2016, Procesverbali nr.5, datë 23.11.2016, procesverbali nr.6, datë 23.11.2016, procesverbal nr. 7, datë 13.10.2016**

6. **Për z. S. Q**, me detyrë inspektor për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit për vitin 2015 praktikat 9,17, 18,23, për 6/mujorin e I-rë vitin 2016 praktikat 4, 6, 9,11,12,14,15,16 **Procesverbali nr. 2, datë 19.11.2016**

7. **Për znj. A. Q**, me detyrë inspektor, për vitin 2014 praktikat 7, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit **Procesverbali nr. 2, datë 19.11.2016, procesverbali nr.6, datë 23.11.2016, procesverbali nr. 8 datë 13.10.2016,**

C/3. Mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në nenin 57 “Përgjegjësia për masat disiplinore”, nenin 58 “Llojet e masave disiplinore”, germa “b” e “ç” dhe nenin 59 “Kompetenca dhe procedura për masat disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil”, në ligjin nr.10433, datë 16.06.2011”Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjit nr, 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i rekomandoj Kryeinspektorit ISHU Tiranë, vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës me status nëpunësi civil fillimin e procedurave për dhënien e masës disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Mosngritje në detyrë deri 2 vjet”,” për:

Për 10 punonjësit inspektor të ish-sektorit të Ujërave, transferuar në Degën Rajonale ISHU Qarku Vlorë në varësi të ISHU Tiranë strukturë e Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

1. **Për z. B. B**, me detyrë ish-Përgjegjës i Sektorit të Ujërave për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalet nr.7, datë 13.10.2016

2. **Për z.A .P**, me detyrë inspektorë mjedisi ne Sektorin e Ujërave, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalet nr.7, datë 13.10.2016

3. **Për znj. O. Zh**, me detyrë inspektorë mjedisi ne Sektorin e Ujërave, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalet nr.7, datë 13.10.2016

4. **Për z. A .S**, me detyrë inspektorë mjedisi ne Sektorin e Ujërave, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalet nr.7, datë 13.10.2016

5. **Për znj. F .M**, me detyrë inspektorë mjedisi ne Sektorin e Ujërave, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalet nr.7, datë 13.10.2016

6. **Për z. I. K**, me detyrë inspektorë mjedisi ne Sektorin e Ujërave, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalet nr.7, datë 13.10.2016

7. **Për z.G .Dh, inspektorë të Sektorit të Ujërave**, me detyrë inspektorë mjedisi ne Sektorin e Ujërave, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit dhe në procesverbalet nr.7, datë 13.10.2016

PËR PUNONJËSIT E LARGUAR DHE QË NUK KANË ADRESIM INSTITUCIONAL.

I. Për **4** ish-punonjësit që kanë ndërprerë marrëdhëniet e punës nuk rekomandojmë masa disiplinore. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore do të ishte nga “**vërejtje**” deri në “**Ndërprerje të marrëdhënieve të punës**”, përkatësisht për:

1. Për z. A .H, me detyrë ish-inspektor deri shkurt v.2015, larguar për mosplotësim kriteresh, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit për vitin 2014 praktikat 8, **Procesverbali nr. 2, datë 19.11.2016,**

2. Për z. E .H, me detyrë ish-jurist dorëhequr prill 2015, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit ndjekjen e procedurës së gjobave **Procesverbali nr. 4, datë 22.11.2016, Procesverbali nr. 9, datë 23.11.2016,**

3. Për z. A .D, me detyrë ish- Inspektor në sektorin e Inspektimit të Ujërave larguar për mosplotësim kriteresh, për shkeljet trajtuar në faqet e Raportit Përfundimtar të Auditimit **Procesverbali nr. 7, datë 23.11.2016,**

Për 11 punonjësit aktual, për 7 punonjësit inspektor të ish-sektorit të Ujërave, transferuar në Degën Rajonale ISHU Qarku Vlorë në varësi të ISHU Tiranë, strukturë e Ministrisë Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Ujërave, dhe për 4 punonjësit e larguar përcaktuar më sipër masat kërkohen:

-Për moszbatim të kërkesave të ligjit nr. 10433, datë 16.06.2011”Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr, 10431, datë 09.06.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” ligjit nr. 8485 “Kodi i Procedurave Administrative”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore në ndryshim dhe zbatim të tyre.

-Për të metat e mangësi të konstatuara, në zbatimin e procedurave ligjore e nënligjore në pranimin dhe administrimin e dokumentacionit tekniko ligjor në procesin e trajtimit përfundimtar të pronës dhe të njohjes, kthimit dhe kompensimit të pronave, sipas trajtimit në procesverbale dhe në kapitujt përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit të paraqitur për DRISHMP Vlorë.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Administrimit Aseteve, Kontrollit të Territorit dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikes.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R